

NO  
E



**Gjithmonë në rritje  
të qëndrueshme**

RAPORT  
VJETOR  
2018



BANKA KOMBETARE TREGTARE



**Gjithmonë**





Novatorë

# BKT PËRMES SHIFRAVE



Treguesit Kryesorë	2015	2016	2017	2018	Ndryshimi %
Totali i Aktivit (në milionë Euro)	2,501	2,861	3,058	3,443	12.59%
Totali i Huave (në milionë Euro)	840	954	980	1,062	8.39%
Totali i Depozitave (në milionë Euro)	2,037	2,226	2,397	2,734	14.09%
Kapitali Aksionar (në milionë Dollarë)	294	350	391	435	11.07%
Fitimi Neto (në milionë Dollarë)	58	56	68	75	11.05%

RAPORTET KRYESORE	2015	2016	2017	2018
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	13.99%	14.08%	14.28%	17.53%
Kthimi mbi Aktivet Mesatare	1.75%	1.94%	2.16%	1.93%
Kthimi mbi Kapitalin Neto	19.03%	19.12%	20.51%	18.74%


## STRUKTURA AKSIONERE

Çalik Finansal Hizmetleri, filial i Çalik Holding është aksioner i vetëm i BKT-së.


### Struktura Aksionere

deri më 31 Dhjetor 2017	Numri i aksioneve	Totali në USD	%
Çalik Finansal Hizmetler A.Ş.	24,291,498	300,000,000	100


Totali i Aktivit ( milionë EURO )




Fitimi Neto ( milionë USD )




Totali i Huave ( milionë EURO )




Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ( % )




Totali i Depozitave ( milionë EURO )




Kthimi mbi Aktivet Mesatare ( % )



Kapitali i Aksioner ( milionë USD )



Kthimi mbi Kapitalin Neto ( % )







THEMELUAR NGA AHMET ÇALIK, ÇALIK HOLDING VEPRON NË SEKTORËT E ENERGISË, NDËRTIMIT DHE PASURIVE TË PALUAJTSHME, TEKSTILEVE, INDUSTRIË SË MINIERAVE, FINANCËS DHE TELEFONISË. ME AKTIVITET TREGTAR TË SHTRIRË NË 22 VENDE NGA AZIA QENDRORE, NË RAJONIN E BALLKANIT, LINDJEN E MESME DHE AFRIKËN E VERIUT (RAJONI MENA), GRUPI NUMËRON 30,000 TË PUNËSUAR.

**Ç**alik Holding, përfaqëson një nga grupet më të fuqishme në Turqi dhe në botë me shoqëritë e grupit; në sektorin e energjisë me Çalik Enerji; në eksplorimin e naftës me Çalik Petrol, në shpërndarjen e energjisë elektrike me YEDAŞ, YEPAŞ, KEDS në partneritet me Limak, ARAS EDAŞ dhe ARAS EPAŞ në partneritet me Kiler; në sektorin e ndërtimit me Gap İnşaat dhe Çalik Gayimenkul; në miniera me Lidya Madencilik dhe Polimetal Madencilik; në tekstile me Çalik Denim dhe Gap Pazarlama; në financa me Aktif Bank, BKT Shqipëri (Banka Kombëtare Tregtare) dhe BKT Kosovë, në sektorin e telekomunikacionit me Altelecom dhe në fushën digjitale me Çalik Digital.





Në spektrin e veprimtarive tregtare të grupit në vende të ndryshme të botës, Çalık Holding, me një reputacion të pacenueshëm, një strukturë solide financiare dhe bashkëpunim afatgjatë me shoqëri ndërkombëtare, gjeneron vazhdimisht modele novatore të biznesit për të ecur përpara në përmbushje të zhvillimit të qëndrueshëm në çdo fushë ku operon. Çalık Holding, ka si mision shtimin e vlerave të përhershme në jetën e njerëzve në çdo vend të botës ku ushtron veprimtari, duke vijuar me fokus të veçantë në digjitalizimin e proceseve, shërbimeve dhe produkteve të tij të biznesit falë mundësive të reja që Industria 4.0 ofron për botën e biznesit.



# MOMENTE HISTORIKE

## 1925

Inaugurimi i selisë së bankës në Durrës më 30 nëntor 1925.

## 1993

BKT merr emrin e sotëm pas shkrires së Bankës Tregtare Shqiptare (BTSH) dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH).

## 1997

BKT-ja merr formën e një Shoqërie Aksionare në korrik të vitit 1997, ku aktivet arrijnë vlerën 2.7 miliardë lekë.

## 2000

BKT përfundon procesin e privatizimit. Aksionarët e rinj investojnë 10 milionë USD, çka solli kapitalizimin e fortë të bankës.

## 2001

Struktura e aksionarëve të rinj i sjell BKT-së transformime të rëndësishme, duke përfshirë zhvillimin e një infrastrukture të re dhe ristrukturimin e të gjitha operacioneve të bankës.

## 2006

60% e aksioneve të BKT-së i transferohen Çalik - Şeker Konsorsiyum Yatırım A. BKT nderohet me çmimin **"Banka më e Mirë e Vitit në Shqipëri"** nga revista "The Banker".

## 2007

Një degë e re hapet në Prishtinë, Kosovë, në nëntor 2007 si investimi i parë i huaj i BKT-së.

## 2008

"JCR Eurasia Rating" e vlerësoi BKT-në me AAA (Alb). BKT-ja u veçua si banka më e mirë ndër bankat e nivelit të mesëm në Evropën Juglindore dhe si **"Banka më e Mirë në Shqipëri"**.

## 2009

BKT-ja bëhet 100% filial i Grupit Çalik pas blerjes së aksioneve të mbetura nga Çalik Finansal Hizmetler. BKT-ja është vlerësuar si **"Banka më e Mirë e Evropës Juglindore për vitin 2009"**.

## 2010

BKT feston 10 vjetorin e privatizimit dhe 85 vjetorin e degës së parë në Durrës me shumë çmime dhe tituj nderi. **"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker"**. **"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance"**. **"JCR Eurasia Rating" vlerëson me "AAA (Alb)" me situatë "të qëndrueshme"**.

## 2011

BKT-ja vazhdon të ketë një ecuri të lartë gjatë vitit 2011, duke e vendosur në pararojën e sektorit financiar në Shqipëri. BKT-ja nënshkruan një marrëveshje financimi për linjat tregtareme Korporatën Islamike Tregtare dhe Financiare (ITFC). Në bazë të kësaj marrëveshjeje, banka kryen transaksionin e parë murabaha në Shqipëri. **"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker"**. **"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance"**. **"JCR Eurasia Rating" vlerëson me "AAA (Alb)" me situatë "të qëndrueshme" dhe "Moody's" konfirmoi vlerësimin me "B1"**

## 2012

Çmimet dhe vlerësimet pozitive vijnë, duke reflektuar suksesin e BKT-së në tregun shqiptar. Revista e shquar britanike "EMEA Finance" shpall Z. Seyhan Pencabıgil si "Drejtori Ekzekutiv i Vitit 2012 në Evropë". **"Banka më e Mirë në Shqipëri" për vitin 2012 nga "Euromoney"**. **"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance"**. **BKT certifikohet me "ISO 9001:2008" për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë të përshtatshme për shërbimet bankare nga TÜV AUSTRIA CERT.** **"JCR Eurasia Rating" vlerëson me "AAA (Alb)" me një situatë "të qëndrueshme"**. **Banka u vlerësua me "AA (Alb)/Merit" për Qeverisjen e Korporatave nga JCR Eurasia Rating**



# 2013

BKT vijon me përmirësimin dhe ofrimin e standardeve më të larta të përfaqësimit në industrinë bankare. Po ashtu, gjatë vitit 2013, Shoqëria Islamike e Leasingut në Shqipëri, "Albania Leasing", u themelua në partneritet me BKT-në.

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "Euromoney".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance".**

**"JCR Eurasia Rating" e vlerësoi me "AAA (Alb)" me situatë "të qëndrueshme".**

**Banka u vlerësua me "AA (Alb)/Merit" për Qeverisjen e Korporatave nga JCR Eurasia Rating**

# 2014

BKT bëhet zyrtarisht banka më e madhe për aktivet në sistemin bankar në Shqipëri dhe vazhdon traditën e fitimit të çmimeve gjatë vitit 2014,

**Revista "Euromoney" nderon BKT-në me vlerësimin si "Banka më e Mirë në Shqipëri" dhe "Çmimin për Përgjegjësinë Sociale të Korporatave në Evropën Qendrore dhe Juglindore dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker".**

**"JCR Eurasia Rating" vlerëson me "AAA (Alb)" me një situatë "të qëndrueshme".**

**Banka u vlerësua me "AA (Alb)/Distinctive" për Qeverisjen e Korporatave nga JCR Eurasia Rating**

# 2015

BKT feston 90 vjetorin, duke marrë sërish tre çmimet më të rëndësishme të industrisë së financave:

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "Euromoney".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance".**

**"JCR Eurasia Rating" e vlerësoi me "AAA (Alb)" me situatë "të qëndrueshme".**

**Banka u vlerësua me "AA (Alb)/Distinctive" për Qeverisjen e Korporatave nga JCR Eurasia Rating**  
**Çmimin "Silver Award" për bankat për Raportin Vjetor të BKT-së për vitin 2014 në konkursin mbarë botëror ARC të organizuar nga MERCOMM Inc.**

**Çmimin "Honor Award" për Raportet Vjetore të Gjelbra/Miqësore me Mjedisin për vitin 2014 në konkursin mbarë botëror të ACR nga MERCOMM Inc.**

# 2016

Falë ecurisë së saj të qëndrueshme, BKT nderohet me çmime prestigjioze në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "Euromoney".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker".**

**"JCR Eurasia Rating" vlerëson me "AAA (Alb)" me një situatë "të qëndrueshme".**

**Banka u vlerësua me "AA (Alb)/Distinctive" për Qeverisjen e Korporatave nga JCR Eurasia Rating**

# 2017

BKT vazhdon të ofrojë produkte, shërbime dhe zgjidhje novatore duke i shtuar vlerat një bazë të gjerë klientësh, nëpërmjet një platforme të qëndrueshme shërbimesh me 93 degë në Shqipëri dhe në Kosovë. Në vitin 2017, BKT-ja bëri pagesën e parë të dividendëve prej 30 milionë dollarësh amerikanë.

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "Euro-money".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker".**

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance".**

**"JCR Eurasia Rating" e vlerësoi me "AAA (Alb)" me situatë "të qëndrueshme".**

# 2018

Viti 2018 ishte vit shumë i veçantë për BKT, kjo falë finalizimit të procesit në të cilin BKT Kosova u bë filial i BKT Albania, si dhe, për të dytin vit radhazi, u krye pagesa e dividendit prej 30 milion dollarësh amerikanë.

**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "The Banker".**


**"Banka më e Mirë në Shqipëri" nga revista "EMEA Finance".**

**"JCR Eurasia Rating", ka vlerësuar Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) në terma afatgjatë në nivel kombëtar me notën "AAA (Alb)"**

**dhe në terma afatshkurtër në nivel kombëtar me notën "A-1+ (Alb)", me një situatë "të qëndrueshme"**

**BKT-ja është certifikuar me "ISO 9001:2015" për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë të përshtatshme për shërbimet bankare nga TÜV AUSTRIA CERT.**

# BORDI DREJTUES



**GALIP TÖZGE**  
ANËTAR BORDI

**MEHMET  
ERTUĞRUL  
GÜRLER**  
ZËVENDËS  
KRYETAR





**SEYHAN  
PENCABLIĞİL**  
DREJTOR I  
PËRGJITHSHËM  
DHE ANËTAR BORDI



**MEHMET USTA**  
KRYETAR BORDI



**AYŞEGÜL ADACA**  
ANËTARE BORDI



# DREJTORËT



**SEYHAN  
PENCABLIGİL**  
DREJTOR I  
PËRGJITHSHËM  
DHE ANËTAR BORDI



**KAAN PEKIN**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË THESARIT DHE  
INSTITUCIONEVE  
FINANCIARE



**SKËNDER EMINI**  
DREJTOR I GRUPIT  
FINANCIAR DHE TI





**AYDIN ARGIN**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË BANKINGUT TË  
KORPORATAVE DHE  
BIZNESIT

**MIRANDA ÇITOZI**  
DREJTORE  
E GRUPIT TË  
OPERACIONEVE



**FATİH KARLI**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË BANKINGUT  
INDIVIDUAL

**İBRAHİM YAŞAR**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË AUDITIT TË  
BRENDSHËM



**NDUE MALUTA**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË MENAXHIMIT TË  
RISKUT

NË VITIN 2018, TREGUESIT EKONOMIKË DHE FINANCIARË TË SHQIPËRISË VIJUAN RIKTHIMIN DREJT NIVELE PARA KRIZËS, DUKE TREGUAR PËRMIRËSIMIN DHE PRIRJE POZITIVE. REFORMAVE TË NDËRMARRA PËR TË KONTRIBUAR NË RITJEN EKONOMIKE NËPËRMJET DIVERSIFIKIMIT TË KANALEVE TË INVESTIMEVE IU BASHKUA EDHE ROLI I RËNDËSISHËM QË LUAJTI SEKTORI BANKAR DHE FINANCIAR. ME NJË POZICION TË FORTË SI BANKA MË E MADHE, MË E FUQISHMJA FINANCIARISHT DHE E MË E BESUESHMJA NË TREGUN E BANKINGUT NË SHQIPËRI, BKT KA VIJUAR TË OPEROJË NË NJË MJEDIS NXITËS BIZNESI DUKE I QËNDRUAR BESNIKE ROLIT TË SAJ THELBËSOR SI OFRUESE E SHËRBIMEVE FINANCIARE BAZUAR NË PARIME DHE VLERA TË MIRË PËRCAKTUARA.

Viti 2018 përkoi me 93 vjetorin e themelimit të BKT-së si edhe me 18 vjetorin e privatizimit të saj, duke vijuar në udhëheqjen drejt zhvillimeve teknologjike për t'i shërbyer sa më mirë nevojave të klientëve tanë. Ky vit dëshmoi në zhvillimin e rrjetit të degëve të BKT-së në sistemin bankar shqiptar si dhe në eficientë në rritje të kanalet tona të shpërndarjes si ATM, Internet dhe Mobile Banking, me theks në rritjen e produktivitetit dhe përfitueshmërisë nga aplikimi i teknologjisë më të fundit në bankingun digjital.

BKT, si banka tregtare më e madhe dhe me historikun më të hershëm në Shqipëri, mbylli vitin 2018 me një vlerë totale të aktiveve më shumë se 3.9 miliardë dollarë amerikanë, me një total depozitash prej 3 miliardë dollarë amerikanë, duke u shërbyer klientëve të saj nëpërmjet një rrjeti prej 94 degësh, 67 prej tyre në Shqipëri dhe 27 në Kosovë. Megjithatë, nuk flitet vetëm për shifra mbresëlënëse, pozitën solide të korporatës dhe inkurajimit të rritjes; vlera jonë bazike ka të bëjë thellësisht me përkushtimin dhe përkujdesjen tonë ndaj njerëzve, të cilët janë në zemër të asaj që ne përfaqësojmë dhe në atë çfarë bëjmë, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Revista "The Banker" vlerësoi BKT-në si "Banka më e mirë në Shqipëri për vitin 2018". Përveç këtij vlerësimi, "JCR Eurasia Rating" vlerësoi BKT-në për kategorinë e investimeve të nivelit të lartë dhe në terma afatgjatë në nivel kombëtar me notën "AAA (Alb)", dhe në terma afatshkurtër në nivel kombëtar me notën "A-1+ (Alb)", me një situatë "të qëndrueshme" për të dyja vlerësimet. Ndërkohë, vlerësimet e dhëna për "Notën Afatgjatë Ndërkombëtare në Monedhë të Huaj dhe Vendase" u konfirmuan me vlerësimin "BBB-", vlerësim superior ky me një nivel më lart se vlerësimi maksimal i vendit. Për më

tepër, "EMEA Finance" përcaktoi BKT-në si "Banka më e Mirë Lokale në Shqipëri", duke theksuar se "BKT-ja kapi momentin dhe vijoi me riorganizimin, rikrijimin dhe gjetjen e instrumenteve për vitin në vazhdim dhe sfidat e ardhshme, ato të parashikuara dhe të paparashikuara!"

Organizimi dhe mbështetja financiare për të tretin vit radhazi i tryezës rrumbullake të Shqipërisë për "Mobilizimin e Financave për Rritje" në kuadër të Forumit të 23-të të Evropës Qendrore dhe Lindore në Vjenë, me pjesëmarrjen e autoriteteve shqiptare të financave, e vendosën Shqipërinë në pararojën e zhvillimeve bankare. *Euromoney*, e cila e vlerësoi në krye të herës BKT-në si "Banka më e mirë në Shqipëri" në 2012, e organizoi këtë konferencë me qëllim sjelljen së bashku mbi 1,200 përfaqësues qeverish, politik-bërës, ndërmjetës financiarë, drejtues biznesi dhe investitorë të interesuar në Evropën Qendrore dhe Lindore.

BKT ka marrë gjithashtu vlerësime në tregun shqiptar të bankave. Në vitin 2018, Agjencia e Sigurimit të Depozitave përzgjedhi BKT-në si fituese të listës paraprake me tre banka që shërbejnë si banka agjente për kryerjen e procesit të kompensimit të depozitave. BKT është banka e parë e cila do të operojë si bankë agjente në Shqipëri. Ky proces, i cili filloi pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe finalizimit të të gjitha detajeve do të synojë ndërtimin e mekanizmave dhe infrastrukturës së nevojshme për konsolidimin e stabilitetit të sektorit financiar dhe qëndrueshmërisë së sistemit bankar në rast të ndonjë situatë apo rreziku të papritur.

Si pjesë e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës, bashkëpunimi 11-vjeçar i BKT-së me Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën në Universitetin "Aleksandër Moisiu"





Durrës, ka njohur zhvillime të mëtejshme, ndërsa BKT ka vijuar të mbështesë pjesëmarrjen e lektorëve dhe ekspertëve të huaj në programin akademik të këtij universiteti. Përveç kësaj, BKT ka mbështetur Iniciativën e “Revolucionit të Gjellbër” të Bashkisë së Tiranës për pyllëzimin e kryeqytetit duke sponsorizuar një projekt për mbjelljen e pemëve përreth Liqenit Artificial të Tiranës në prill, si edhe me pjesëmarrjen në një iniciativë të ngjashme në Bashkinë e Kamzës. Për më tepër, BKT ka vijuar të mbështesë traditën e Panairit “Work and Study”, si edhe panairë të tjera në qytete të ndryshme e institucione arsimore, duke ofruar kontribute të vlefshme në tregun e punës dhe të studimit në Shqipërisë.

Ndërsa arritjet tona të konsiderueshme në vitin 2018 na motivojnë të vijojmë të qëndrojmë në krye të tregut bankar të Shqipërisë, ne mbetemi plotësisht të vetëdijshëm se nuk janë vetëm çmimet që na bëjnë krenarë; është besimi që na është dhënë. Në emër të Bordit të BKT-së, do të doja të përfitoj nga ky rast për të falënderuar të gjithë punonjësit tanë, si dhe aksionarët dhe klientët, të cilët janë pjesë e pandarë e rrugëtimit tonë. Nuk ka të bëjë vetëm me të qenit numri një; ka të bëjë me të gjithë ne të bashkuar në rrugëtimin tonë të përbashkët për të realizuar objektiva me vlera të vërteta.

**MEHMET USTA**  
KRYETAR I BORDIT DREJTUES

## TË NDERUAR PARTNERË,

---

Viti 2018 ishte një vit me dinamika në sistemin bankar për sa i përket shkrirjeve dhe blerjeve. Gjysma e bankave në treg ose janë blerë ose janë bashkuar, me një rezultat të tanishëm prej 13 bankash në sistemin bankar (2017: 16), ndërsa dy banka kanë aksionarë të ndryshëm. Më pak banka nënkupton konkurrencë më e fortë, të cilën e mirëpresim, të mirë-përgatitur siç jemi.

Jam i lumtur të raportoj se 2018-a ishte një vit tjetër në të cilin arritëm të përmbushnim të gjitha objektivat kryesore. Të ardhurat totale për vitin ishin 75 milion dollarë amerikanë (2017: 68 milionë dollarë amerikanë), duke rezultuar në 435 milionë dollarë amerikanë në kapital dhe një kthim mbi kapitalin prej 19%. Paguam një dividend prej 30 milionë dollarësh amerikanë, në përputhje me politikën tonë të kthimit të kapitalit shtesë tek aksionarët, pasi janë përmbushur nevojat rregullatore dhe strategjike të bankës, përshirë këtu rritjen potenciale.

Një moment historik u shënua në vitin 2018 ku dega jonë në Kosovë u shndërrua në një filial. BKT-Kosova përfaqëson tashmë një bankë të konsoliduar, duke zënë rreth 10% të tregut dhe financa të shëndetshme. Kërkesa jonë për tu zgjeruar në tregun ndërkombëtar vazhdon si në vendet fqinje, ashtu edhe në vendet e tjera ku vepron Çalik Group. Performanca jonë për vitin 2018 është vlerësuar sërish me çmimet më të rëndësishme ndërkombëtare bankare, vlerësime që na bëjnë të ndihemi krenarë, por kurrësi të vetëkënaqur.

Të motivuar presim vitin 2019, ku do të fokusohemi tek më shumë kredi-dhënie dhe përdorimi i teknologjisë së fundit me efikasitet. Ne do të përqendrohemi tek stafi drejtues gjithashtu, ku çdo drejtues i BKT-së do të përfaqësojë një lider të vërtetë të ekipit të tyre. Do të jetë kjo udhëheqje e harmonizuar që do të na sjellë sukses në vitin 2019 dhe më tej.



**SEYHAN PENCABLIGİL**  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
DHE ANËTAR BORDI



## V L E R Ë S I M E T

“JCR Eurasia Rating”, një nga agjencitë më prestigjioze të vlerësimit në botë, vlerësoi se BKT ka ruajtur pozicionin e saj si banka më e madhe në sistemin bankar shqiptar në lidhje me aktivet, kreditë, depozitat dhe kriteret e përcaktimit së madhësisë së fitimit neto.

Sipas kategorisë për nivelin më të lartë të investimit, JC-ER ka vlerësuar Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) në terma afatgjatë në nivel kombëtar me notën “AAA (Alb)”, dhe në terma afatshkurtër në nivel kombëtar me notën “A-1+ (Alb)”, me një situatë “të qëndrueshme” për të dyja vlerësimet. Ndërkohë vlerësimet e dhëna për “Notën Afatgjatë Ndërkombëtare në Monedhë të Huaj dhe Vendase” u konfirmuan me vlerësimin “BBB-”, vlerësim superior ky me një nivel më lart se vlerësimi maksimal i vendit.



Kryetari i Bordit Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i BKT-së gjatë pranimit të çmimit nga The Banker.



## Ç M I M E T

**R**evista “The Banker” vlerësoi BKT-në si “Banka më e Mirë e Vitit në Shqipëri” për herë të nëntë. Ky çmim konfirmon pozicionin drejtues të BKT-së brenda sistemit bankar shqiptar, jo rastësisht në këtë pozicion, falë përqafimit të një qasje novatore duke investuar vazhdimisht në teknologji si banka pioniere e zbatimit të risive më të fundit, duke ruajtur në të njëjtën kohë trashëgiminë dhe lavdinë si banka më të vjetër në Shqipëri.

Suksesi i Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) u pasqyrua edhe në vlerësimin e revistës prestigjioze të financave ndërkombëtare “EMEA Finance”, duke e cilësuar BKT-në si “Banka më e Mirë Lokale në Shqipëri” për të tetin vit radhazi. Ky çmim përsëri erdhi si vlerësim i njohjes së përpjekjeve të vazhdueshme të BKT-së për të ofruar përvojën më të mirë bankare tek të gjitha palët e interesit.



# Gjithmonë







punojmë në ekip



## RAPORTI VJETOR 2018

**V**iti 2018, për Bankën Kombëtare Tregtare në Kosovë shënoi një vit sukcesi, gjatë të cilit BKT Kosova konsolidoi pozicionin e saj në treg dhe prezantoi produkte dhe shërbime të reja për klientët e saj.

Rezultatet e vitit 2018 dëshmojnë për forcën dhe potencialin tonë si bankë. Një performancë e vazhdueshme financiare e qëndrueshme flet për një biznes të shëndetshëm, të cilin e kemi ilustruar gjatë 11 viteve të veprimtarisë tonë në tregun e Kosovës.

Banka njohu fitim të konsiderueshëm duke e mbyllur vitin me 5.96 milionë euro fitim neto. Nivelet e asetëve arritën në 415 milionë euro, duke njohur një rritje prej 20%. Totali i depozitave u rrit me 16%, duke arritur në 351 milionë euro, ndërkohë që totali i kredive arriti në vlerën e 248 milionëve euro, duke treguar një rritje me 17%.

Është për tu theksuar se BKT Kosova ka ndërmarrë hapa të mëdhenj sukcesi drejt krijimit të themeleve të forta për një rritje afat-gjatë. Banka riorganizoi divizionet e saj të biznesit për përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit të punës dhe ristrukturoi degët e saj për të siguruar një efikasitet më të lartë shërbimi ndaj klientëve.

Gjatë vitit 2018, BKT Kosova gëzoi besueshmëri të shkëlqyer nga klientët, e reflektuar kjo në bazën e depozitave e cila njohu një rritje të konsiderueshme duke tejkaluar pritshmëritë.


Një sektor ku banka u fokusua ishte Financimi i

Projekteve, me fokus të veçantë në energjinë e ripërtërishme dhe projekte të ndryshme infrastrukturore. Gjatë vitit 2018, banka financoi kryesisht projektet e hidrocentraleve dhe projektet e ndërtimit, si dhe arriti të formojë një portofol prej rreth 5 milionë eurosh në një periudhë gjashtë mujore. Qëllimi ynë është të financojmë projekte që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës dhe kontribuojnë në zhvillimin e saj ekonomik.


Sukcesi ynë i vazhdueshëm nuk do të ishte i mundur pa punonjësit tanë besnikë; prandaj, ne vijojmë të angazhohemi për të vlerësuar sa më shumë punonjësit tanë duke investuar në trajnimin dhe zhvillimin e tyre. Banka e ka përcaktuar rrugën për sukses të vazhdueshëm në 2019 dhe për vitet në vijim, duke u fokusuar kryesisht në nevojat dhe pritshmëritë e klientëve tanë, si dhe duke investuar në mënyra dhe teknologji të reja me qëllim lehtësimin e transaksioneve bankare.

Në përfundim, BKT Kosova është këtu për të mundur rritjen ekonomike dhe zhvillimin social duke gjeneruar ndikim pozitiv për klientët, personelin e saj, investitorët dhe komunitetin në tërësi. BKT Kosova përfaqëson një bankë, veprimtaria e së cilës është e vazhdueshme, produktive, kuptimplotë dhe e qëndrueshme; një bankë e cila është e besueshme, humane, me performancë të lartë; një bankë e cila harmonizon suksesin ekonomik me përgjegjësinë ndaj mjedisit dhe shoqërisë.


Totali i Aktivit ( milionë EURO)




Fitimi Neto ( milionë EURO)




Totali i Huave ( milionë EURO)




Pjesa e Tregut për Totalin e Aktivit (%)



Totali i Depozitave ( milionë EURO)



Numri i Degëve





**NAIM RATKOCERI**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË MENAXHIMIT  
TË KREDIVE DHE  
LIGJOR



**NJOMZA BUXHOVI**  
DREJTORE E GRUPIT  
TË BANKINGUT  
INDIVIDUAL




**ELTON XHAFAJ**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË AUDITIT TË  
BRENDSHËM



**AGON SKEJA**  
DREJTOR I GRUPIT TË  
KONTABILITETIT DHE  
KONTROLLIT FINNACIAR




A portrait of Suat Bakkal, a man with short dark hair, wearing a dark navy suit, a light blue shirt, and a purple tie. He is standing against a white background.

**SUAT BAKKAL**  
DREJTOR I  
PËRGJITHSHËM  
DHE ANËTAR BORDI

A portrait of Albion Mulaku, a man with short dark hair, wearing a blue suit, a white shirt, and a patterned tie. He is standing against a white background.

**ALBION MULAKU**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË BANKINGUT  
TË BIZNESIT DHE  
KORPORATAVE

A portrait of Muharrem Inan, a man with short dark hair, wearing a dark navy suit, a white shirt, and a black tie. He is standing against a white background.

**MUHARREM INAN**  
DREJTOR I GRUPIT  
TË THESARIT DHE  
INSTITUCIONEVE  
FINANCIARE

BKT PO NDJEK NJË QASJE *AMBIDEXTROUS*<sup>1</sup> PËR RUAJTJEN E THEMELEVE SOLIDE TË KLIENTËVE TË SAJ, E CILA BAZOHET TEK TË QËNIT NJË SIMBOL BESIMI - SI BANKA MË E VJETËR, MË E MADHE DHE MË E MIRË - VLERA KËTO QË SHKOJNË PARALEL ME INVESTIMET NË TRANSFORMIMET DIGJITALE, PAVARËSISHT REZULTATEVE AFAT-SHKURTRA, NË PARAROJË TË NDRYSHIMEVE NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR PËR RRIJTJEN E CILËSISË SË SHËRBIMIT DUKE TEJKALUAR PRITSHMËRITË E KLIENTËVE. BKT ËSHTË GJITHMONË E DEDIKUAR NË SFIDËN DREJT VETES ME QËLLIM VENDOSJEN E STANDARDEVE TË REJA NË SEKTORIN FINANCIAR



Financimi i nevojave të individëve përbën gjithmonë një nga prioritetet më të rëndësishme të BKT-së. Banka gjatë vitit 2018 ka rritur vëllimin e kreditimit dhe ka ruajtur pjesën e saj të tregut me mbi një të pestën e tregut të kredive për individë në Shqipëri duke financuar klientët e saj në çdo pikëpamje të jetës së tyre, nga strehimi në arsim, shëndetësi, martesë dhe më gjerë. BKT gjithashtu lehtëson mënyrën e jetesës së klientëve të saj duke i financuar nëpërmjet kartës Prima me pagesa me këste në shumicën e sektorëve në Shqipëri dhe jashtë vendit. Si rezultat i ecurisë së suksesshme, BKT rriti përfitueshmërinë në sektorin bankar për individë me 19% krahasuar me një vit më parë. (BKT po përdor një sistem “udhëzimi dhe përfitueshmërie” për të matur përfitueshmërinë nga produkti deri në nivel konsumatori.)

BKT gjithmonë ka kryesuar tregun me kredinë hipotekare duke ofruar alternativa të shumta dhe zgjidhje inovative për të përmbushur nevojat e klientëve. Banka ofron mundësi për financimin e shtëpive si në monedhën vendase ashtu edhe në euro dhe madje lejon fleksibilitetin në kalimin nga monedha e huaj në monedhën vendase. Fleksibiliteti nuk kufizohet nga monedha; maturiteti fleksibël është një zgjidhje tjetër novatore dhe e unike për klientët tanë: maturiteti i kredive ndryshon automatikisht në varësi të ndryshimeve të normës së interesit në mënyrë që të ruhen të pandryshuara këstet e pagesave. Normat e pandryshuara të interesit, promovime me interes 0% për klientët e rregullt, dhe kreditë për shtëpi për emigrantët janë faktorë të tjerë që e veçojnë bankën tonë. Po ashtu, BKT-ja ka një linjë telefonike të

veçantë (ALO SHPI) për klientë të cilët kërkojnë informacion të hollësishëm rreth kredive hipotekare dhe çështjeve të tjera. Pothuajse gjysma e tregut të kredive hipotekare në monedhën vendase në Shqipëri i përket BKT-së. Disbursimet e kredive hipotekare janë rritur 27% gjatë vitit 2018 për shkak të aktiviteteve të suksesshme të kreditimit.

BKT ka zgjedhur qëllimisht me vonesë të ofrojë kredi pa kolateral, kjo për shkak të nivelit të lartë të kredive me probleme (NPL) në vend (për shkak të mungesës së njohurive dhe traditës së kreditimit të individëve në të kaluarën), por banka ka filluar të jetë aktive gjatë pesë viteve të fundit duke dyfishuar pjesën e saj të tregut brenda një kohe të shkurtër duke e mbajtur nivelin e NPL-ve në një pikë të kënaqshme (sipas analizës “vintage”). Gjatë vitit 2018, shifrat e reja të disbursimit janë rritur ndjeshëm dhe rritja në pjesën e tregut është përshpejtuar. BKT është mjaft aktive në promovimin e kredisë konsumatore duke ofruar lehtësira për financimin e arsimit, shëndetësisë, kursimit të energjisë dhe më tej. BKT gjithashtu ka aplikuar skemat e përcaktimit të çmimeve të segmenteve sipas ekspozimit të riskut për grupe të ndryshme konsumatorësh.

Kartat dhe Pagesat kanë qenë gjithmonë pikat e forta të BKT-së. Banka përfaqëson pothuajse gjysmën e tregut të kartave të kreditit dhe terminaleve POS. BKT i shërben klientëve të saj me kartën Prima, një produkt unik i cili ofron bonuse dhe alternativa për pagesa me këste, me kosto zero. Klientët Prima mund të bëjnë edhe blerje me këste kur bëjnë blerje në internet ose kryejnë blerje jashtë vendit.



<sup>1</sup>Ambidextrous / Ambidexterity: aftësia për të përdorur të dy duart me lehtësi të barabartë ose shkathtësi. Në organizata, përkufizimi më i pranuar për ‘ambidextrous’ është ekuilibri ndërmjet eksplorimit dhe shfrytëzimit; organizata të afta për të shfrytëzuar kompetencat e tyre ekzistuese duke eksploruar në të njëjtën kohë mundësitë e reja.



Tërheqja e parave nëpërmjet terminaleve POS është një tjetër shërbim unik i BKT-së. Kujdesi për edukimin financiar dhe përfshirjen financiare të klientëve tanë është një nga misionet më të rëndësishme për BKT-në, me synimin drejt reduktimit të ekonomisë gri dhe rritjes së transaksioneve nëpërmjet produkteve bankare. Për transaksione të vogla, nga shoqëritë e taksive tek pagesat e tarifave, BKT është pionere e risisë së shitjeve pa kontakt. Besnikëria është një tjetër mekanizëm për të promovuar përdorimin e kartave, me shumë risi, duke përfshirë lojërat. 2018 ishte një vit tjetër i suksesshëm, me një rritje të konsiderueshme në transaksionet nëpërmjet kartave dhe POS.

BKT ka qenë gjithmonë aktive në transformimin e pagesave nga pikat e shitjes me para në dorë drejt përdorimit të metodave digjitale. BKT është themeluesja e sistemeve të pagesave në Shqipëri duke krijuar sistemin e pagesës së faturave dhe infrastrukturën e pagesave automatike të tyre. Pjesa e tregut që zotëron banka është më shumë se një e treta e transaksioneve me kartat e debitit dhe pothuajse të gjithë tregtarët kryesorë operojnë në partneritet me BKT-në. Gjatë vitit 2018, BKT ka promovuar me sukses kanalet digjitale dhe pagesat automatike për të ndryshuar zakonet dhe mendësinë e klientëve.

BKT simbolizon qëndrueshmërinë dhe përfaqëson një imazh besimi për shkak të përvojës së saj të gjatë dhe pasionit që buron nga e ardhmja premtuese. Ky realitet evidentohet me faktin se banka ka më shumë se një të katërtën e totalit të depozitave në treg dhe më shumë se një të tretën e totalit të depozitave me afat.

Moto jonë është ofrimi i mundësive të panumërta për klientët tanë si edhe për klientët potencialë. Besimi ynë konsiston në ofrimin e zgjidhjeve digjitale nëpërmjet kanaleve digjitale si mënyra më e përshtatshme për të arritur këtë qëllim. BKT ka ndërmarrë hapa të konsiderueshëm për të shndërruar kanalet digjitale në kanale kryesore, duke e cilësuar shërbimin në degë si një alternativë tjetër. Në përmbushje të këtij objekti BKT-ja ka filluar të diferencojë shërbimet e veta jo vetëm në nivelprodukti, por edhe në nivel shërbimi, siç është sistemi i radhës në degët e bankës. Të gjitha

këto ndryshime janë bërë për orientimin e fluksit të klientëve tanë drejt përdorimit të kanaleve digjitale (e-banking dhe mobile banking), me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve në degët e bankës (ku aktualisht, shumicën e kohës të mbushura me klientë). Për hir të së vërtetës, sot më shumë se një në katër persona në Shqipëri që përdorin sistemin bankar digjital janë klientë të BKT-së.

BKT është pioniere e ofrimit të zgjidhjeve digjitale në treg. BKT Smart është aplikacioni më i mirë për shërbimet bankare në Shqipëri, duke ofruar pjesën më të madhe të shërbimeve bankare: shërbimet e njoftimeve interaktive, zënia e radhës nëpërmjet telefonit, pagesa nëpërmjet kodit QR, përdorimi i instrumenteve të marketingut të integruar Beacon. Volumi i transaksioneve nëpërmjet BKT Smart u dyfishua brenda këtij viti për herë të dytë me radhë. Investimet në mobile banking do të vazhdojnë dhe do të shtohen funksionalitete të reja.

Gjatë 2018 programi kompjuterik për bankingun në internet dhe nëpërmjet telefonave inteligjentë u ofrua me opsione të reja duke tejkalar pritshmëritë e tregut. Për më tepër, BKT-ja ndërmori një investim të madh për të rinovuar 70% të rrjetit të vet të ATM-ve me teknologjinë më të fundit për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe funksionalitetet e ATM-ve për të zvogëluar transaksionet me para në dorë brenda degëve. Edhe pse degët e BKT-së janë ende pikat më të populluara të shërbimit në sektorin bankar, BKT-ja realizoi me sukses migrimin e 15% të transaksioneve bankare në kanalet digjitale dhe në këtë mënyrë të rriste transaksionet në internet me 18% përgjatë vitit 2018.

Përdorimi i mediave sociale janë një tjetër arenë në të cilën BKT ka pozicionuar epërsinë e saj, duke qenë marka më e ndjekur dhe e angazhuar në sektorin financiar, me shumë aktivitete dinamike në platformat Facebook dhe Instagram. Këto kanale janë përdorur jo vetëm për promovimin e produkteve, por edhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin financiar dhe madje edhe për argëtim. Ankesat dhe sugjerimet nga ana e klientëve përbëjnë një aspekt tjetër ndërveprimi nëpërmjet mediave sociale dhe Whatsapp.





## MBËSHTESIM MIRËQËNIEN E KLIENTËVE TANË

Ekonomia shqiptare për vitin 2018 dha sinjale rimëkëmbjeje, por ende nën potencialin e saj të rritjes ekonomike, kryesisht mbështetur në disa investime të huaja të mëdha në fushën e energjisë, të parashikuara për t'u finalizuar deri në fund të vitit, si dhe në investimet ambicioze të partneritetit publik-privat, aktualisht në progres. Megjithatë, ecuria e përgjithshme rezultoi pozitive. Rimëkëmbja ekonomike ishte e dukshme dhe ritmi i saj u përmirësua duke gjeneruar rritje në nivelin e punësimit dhe forcuar ekuilibrat e brendshëm e të jashtëm, duke përmirësuar në mënyrë të qënësishme indikatorët kryesorë të sektorit bankar. Burimet ekonomike rezultojnë në rritje dhe të mirë diversifikuara. Përmirësimi i klimës së biznesit ka qenë gjithmonë një prioritet dhe përparimi në kuadrin ligjor dhe rregullator është i dukshëm. Megjithatë, trajtimi dhe përballimi i sfidave në mjedisin rregullator dhe gjyqësor, përgjatë këtij procesi, vazhdon të mbetet thellësisht vendimtar.

Viti 2018 konfirmoi stabilitetin e sistemit bankar shqiptar. Nën spektrin e ndryshimeve të rëndësishme organizative që pritet të finalizohen

gjatë vitit të ardhshëm, viti 2018 mund të konsiderohet një vit i jashtëzakonshëm, ku aktiviteti bankar vijon zgjerimin brenda një sektori të mirë-kapitalizuar, likuid dhe fitimprurës. Raporti i kredive me probleme vijoi të përmirësohet, duke shënuar një rekord të ri të ulët për tetë vitet e fundit, në nivelin prej 12.89 përqind, në shtator. Me një rritje të depozitave, orientuar kryesisht drejt investimeve në tituj dhe më pak në kredidhënie, vlerësimi i kursit të këmbimit dhe fshirja nga bilanci e kredive të humbura patën një ndikim pozitiv në treguesit e performancës së sistemit. Megjithatë, volumi i përgjithshëm i kreditimit në ekonomi vijon të mbetet ende larg potencialit ndërkohë që mundësitë për tu rritur janë ende të shumta.

Përqafimi i ndryshimeve teknologjike dhe përsheptimi i transformimit digjital gjatë vitit 2018, e transformoi BKT-në në një ofruese të shërbimeve dhe produkteve financiare të digjitalizuara dhe të larmishme, duke krijuar një klimë të përgjegjshme biznesi e cila fokusohet tek nevojat e klientit. Ne vijojmë të mbështesim rritjen e qëndrueshme në segmentet e synuara të aktivitetit tradicional dhe të mirë-balancuar të kredisë, i menaxhuar sipas cikleve ekonomike dhe i mbështetur nga një administrim gjithëpërfshirës i portofolit. Ne mbetemi të përkushtuar për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të klientëve tanë

për kredi nëpërmjet vendimarrjeve të drejta, të përgjegjshme dhe të qëndrueshme, të në përshtatje me gjëndjen financiare të klientëve dhe ciklin e aktivitetit të tyre, si dhe duke u ekspozuar në mënyre të kujdesshme ndaj riskut.

Të vetëdijshëm për domosdoshmërinë e mbajtjes së ritmit me zhvillimet në treg dhe për të mbajtur lidhjen me bazën tonë të klientëve, në vitin 2018 ne ofruam zgjidhje financiare për shoqëritë financiarisht të shëndetshme dhe vijam me mbështetjen për projektet me rëndësi strategjike, me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e infrastrukturës së vendit.

Portofoli ynë i kredisë për korporatat dhe biznesin rezultoi me treguesit si në vijim:

-Në fund vitin e 2018-ës, totali i portofolit të kredive të korporatës dhe biznesit në BKT në baza të konsoliduara ishte 740 milionë euro, që korrespondon me një rritje prej 5,1 përqind për vitin.

-Portofoli i kredive të korporatave në Shqipëri përfshirë Sektorin Publik dhe Privat, arriti vlerën e 340 milionë eurove. Kjo shifër i korrespondon një rritjeje vjetore prej 11,8 përqind.

-Portofoli i kredisë për Mikro dhe NVM arriti në një total prej 110 milionë euro që korrespondon me një rritje vjetore prej 2 përqind.

-Portofoli i kredive për projektet e strukturuar, i përfshirë në segmentin e korporatave, u rrit në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit 2018, duke arritur në 157 milionë euro, që korrespondon me një rritje vjetore prej 28 përqind.

Ne vijam t'i shërbejmë klientëve tanë korporatë dhe biznes, ekzistues dhe të rinj, duke konsoliduar marrëdhënien me ta, duke ju ofruar produkte në përputhje me nevojat e tyre përmes kanaleve alternative

të shumta dhe duke u mundësuar kështu bashkëveprimin me ne në mënyrën më të mirë sipas nevojave dhe kërkesave të biznesit të tyre.

-BKT ka kryesuar në financimin e disa projekteve më strategjike në Shqipëri me ndikim të drejtpërdrejtë në PBB-në e vendit për vitet e ardhshme, të tilla si "Rruga e Arbërit", stadiumi i ri "Qemal Stafa", "Miniera e Bakrit TETE në Spaç", Hoteli "HILTON GARDEN INN" dhe "Rruga e Kombit". Disa prej këtyre projekteve tashmë janë përfunduar dhe janë funksionale, ndërsa për disa të tjerë ndërtimi vazhdon ende.

-Numri i kredimarrësve aktivë të biznesit në BKT u rrit me 8 përqind, vit në të cilin banka materializoi një rritje prej 20 përqind sa i përket numrit të klientëve aktivë operacionalë, duke arritur në total 51,340 klientë. BKT-ja renditet e dyta sa i përket portofolit të kredive të biznesit, tek i cili ajo mban 20.55 përqind të tregut.

-Portofoli i kredive për biznes zë pjesën e dytë më të madhe në bilancin e bankës, me 22 përqind në fund të vitit 2018, duke ruajtur

të njëjtin pozicion si vitin e kaluar, dhe duke treguar kështu peshën e kredive të biznesit për bankën.

-Në fund të vitit 2018, interesat e përfituara nga portofoli i kredive të biznesit përbëjnë 32.5 përqind të të ardhurave totale të BKT-së, çka tregon rëndësinë dhe peshën e këtij portofoli.

## VETËM NJË BANKË E FUQISHME MUND TË JETË NJË KËSHILLTAR I PËRJETSHËM

Bankingu për Korporatat dhe Biznesin mbështetet në një strategji efikase të kapitalit i përkushtuar dhe në mbështetje të plotë të klientëve shqiptarë dhe projekteve të tyre investuese apo nevojave afatshkurtra. Nëpërmjet kategorizimit në segmente të ndryshme ne ukemi vënë klientëve në dispozicion një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh, të tilla si kredi për investime, kredi për kapital qarkullues dhe inventar, mbitërheqje në llogari, transaksione bankare, etj.



Miniera TETE, Spaç



Fabrika e trajtimit të peshkut KORAL



# GRUPI I BANKINGUT TË KORPORATAVE DHE BIZNESIT

Nevojat dhe pritshmëritë e klientëve tanë vijnë të zhvillohen edhe më tej, të nxitura nga dinamika e vendit së bashku me mundësitë e shumta për zgjedhje dhe konkurrenca në treg. Ndërkohë që zgjedhja e emrit mbetet, zhvillimet teknologjike vazhdimisht i rrisin pritshmëritë e klientëve tanë. Për të përmbushur kërkesat e tyre, kemi vijuar të zhvillojmë zgjidhje digjitale, duke u munduar të ofrojmë një përvojë tejet cilësore për klientët tanë.

Fokusi ynë i përhershëm vazhdon të mbetet ndërtimi i marrëdhënieve afatgjata me klientët, ndaj dhe ofrimi i mbështetjes së menjëhershme dhe këshillimit financiar në përputhje me nevojat e tyre specifike u përkthye në klientë besnikë dhe 20.55 përqind të tregut për kreditë e biznesit në një ambient të ashpër dhe konkurrues.

Përveç kësaj, përmes programeve të personalizuara të kredihënies dhe skemave të garancisë, kemi përmbushur sfida të biznesit dhe mbështetur rritjen duke zhvilluar produkte të veçanta dhe duke u fokusuar kryesisht në krijimin e një portofoli cilësor të projekteve të specifike, të cilat përfshijnë organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.

BKT-ja vazhdoi të ofrojë mbështetjen e saj të qënësishme në sektorin e bujqësisë në vitin 2018. Në vijim të bashkëpunimit me Fondin për Garantimin e Kredive Rurale (RCGF) një skeme garancie përmes së cilës klientëve u ofrohet 50 përqind garanci, banka ka lëvruar kredi për fermerët në të gjithë vendin. Duke vijuar në mënyrë të sukseshme me këtë program, deri në fund të vitit 2018, shuma e disbursuar shënoi në total 1.8 milionë dollarë për 137 klientë të përfshirë, të cilët kanë shfaqur një performancë të mirë në shlyerjen e kredive.

Bashkëpunimi me Creative Business Solutions (CBS), një projekt i financuar nga USAID, vijoi me sukses edhe për vitin 2018, nëpërmjet të cilit CBS ofroi referencat e veta për Kreditë Agro dhe Klientët Agro. Duke qënë në fokus, financimi i projekteve të strukturuar u menaxhua me maturi, duke konsideruar madhësinë, ndikimin dhe kompleksitetin e tyre, përmes analizave të thelluara, identifikimit dhe zbutjes së menjëhershme të risqeve. Qëllimi ynë është të vijojmë të mbajmë rolin kryesues në treg ndaj këtij segmenti të veçantë dhe të diversifikojmë e pasurojmë shpërndarjen sektoriale si dhe kontributin e drejtpërdrejtë në zhvillimet strategjike të vendit.

Portofoli i projekteve të energjisë së rinovueshme vijoi të rritet falë lëvrimin të kredive të reja, përzgjedhur në bazë të kriterëve të forta, me qëllim ruajtjen e cilësisë së performancës së këtij segmenti.

Bashkëpunimi me sektorin publik u zhvillua edhe më tej gjatë vitit 2018 ku BKT-ja vijon të jetë një nga bankat kryesore në sektor që mbështet nevojat e kapitalit qarkullues të shoqërive publike dhe projektet e tyre të mëdha për investime në shërbim të komunitetit.

## NE PASUROJMË PËRVOJËN E KLIENTIT

Plotësisht të përkushtuar të pasurojmë përvojat e klientëve tanë, gjatë vitit 2018 kemi vazhduar të lançojmë alternativa novatore që bankingu të jetë më i shpejtë, më i lehtë dhe më i sigurt, duke ofruar produkte dhe shërbime të reja dhe miqësore ndaj përdoruesit. Në këtë kuptim, kanë ndodhur zhvillimet/përmirësimet e mëposhtme:



- Në vitin 2018, kemi vendosur në zbatim kategorizimin në segmente të ndryshme të klientëve duke ndarë Portofolin e Klientëve të Biznesit në tri linja: Korporata, SME dhe Mikro. Nëpërmjet këtij modeli i cili koordinohet me projektin e përfitueshmërisë, mund të llogarisim në kohë reale përfitueshmërinë sipas secilit segment, klient, linjës së biznesit dhe bazës së produkteve duke mundësuar ofrimin në këtë mënyrë të paketës më të mirë të çmimeve për çdo klient;

- "Karta e Debitit të Biznesit BankomaT: Në fund të vitit 2018, ne e përfunduam këtë produkt dhe nga janari 2019 të gjithë klientët e biznesit të BKT-së mund ta kenë këtë kartë për të tërhequr ose depozituar para ose për të kryer pagesa të

ndryshme.

- Përmirësimi i E-Banking për biznesin me karakteristika të reja, ku zhvillimi më i rëndësishëm ishte pagesa e pagave online, duke u siguruar shoqërive një kanal efikas të ngarkimit të informacionit të pagave në mënyrë elektronike në sistem dhe kryerjen e pagesave automatike të pagave në datën përkatëse të pagesës.

- Platforma e shërbimit në internet: Kemi rritur numrin e shoqërive që ofrojnë platforma të shërbimit në internet për njohjen e pagesave të klientëve të tyre dhe marrjen e informacionit të pagesave në kohë reale përmes kësaj platforme.

Numri i shoqërive që përdorin e-banking të BKT-së për bizneset, krahasuar me dhjetorin e vitit 2017, është rritur me 50%.

HILTON GARDEN INN - Ceremonia e Hapjes







**Gjithmonë** gati



A collection of 1 Euro coins arranged in a circle around the text. The coins are gold-colored with a silver center, featuring the number '1' and the European Union flag. The text is centered in the middle of the circle.

për mundësi të reja  
investimi

DEPARTAMENTI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE E FILLOI VITIN ME ORGANIZIMIN E NJË TRYEZE TË RRUMBULLAKËT PËR SHQIPËRINË NË FORUMIN E EUROMONEY TË EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE QË U ZHVILLUA NË VJENË. KJO ISHTE HERA E TRETË RADHAZI QË EKONOMIA SHQIPTARE U PREZANTUA PARA NJË AUDIENCE KAQ TË MADHE NGA PËRFAQËSUESIT E MINISTRISË SË FINANCAVE, BANKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT EVROPIAN PËR EVROPËN JUGLINDORE (EFSE).

**N**ë vitin 2018, Grupi i Institucioneve Financiare dhe i Thesarit ishte lideri i padiskutueshëm i tregut financiar të brendshëm shqiptar me një shërbim profesional e cilësor, duke garantuar transaksione tregtare të shpejta, të lehta dhe të besueshme për klientët e saj. Me qëllim garantimin e një tregu më të thelluar dhe më të besueshëm të letrave me vlerë në Shqipëri, Grupi i Institucioneve Financiare dhe i Thesarit e shndërroi BKT-në në një nga pesë bankat që krijoi tregun e letrave me vlerë pesëvjeçare në një projekt pilot të mbështetur nga Banka Botërore, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave. Projekti pilot u përfundua me sukses në fund të vitit 2018, dhe sistemi i krijuesve të tregut është zgjeruar duke përfshirë edhe obligacione 3-vjeçare në fillim të vitit 2019. BKT, në sajë të Grupit të Thesarit dhe Istitucioneve Financiare, ishte banka që realizoi pjesën më të madhe të transaksioneve në obligacione 5-vjeçare në tregun sekondar në vitin 2018.

Grupi i Thesarit dhe Istitucioneve Financiare gjithashtu treguan profesionalizmin e tyre në gjetjen e transaksioneve tregtare më fitimprurëse në tregje dhe produkte të ndryshme financiare, duke

realizuar investime të shumta në Ballkan, në vendet e BRICS dhe tregje të tjera në zhvillim. Transaksionet financiare (në eurobond, repo, kredi të sindikuara, kapitale, mallra dhe kontrata të ardhshme) dëshmuar edhe një herë nivelin e mirë të integritit të Grupit të Institucioneve Financiare dhe të Thesarit dhe suksesin e tyre në tregjet financiare botërore, pavarësisht nga kushtet e tregut. Në vijim të historisë së suksesit, Departamenti i thesarit, në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit të Riskut Operacional, finalizoi vendosjen e sistemit më të fundit Mysis Kondor për Thesarin dhe zyrën mbështetëse, i cili përdoret nga më shumë se 450 klientë në 67 vende. Versioni i fundit i sistemit Mysis Kondor i vjen në ndihmë BKT-së të zbusë rrezikun e tregut dhe rreziqet operacionale dhe të përmirësojë brenda bankës të gjitha proceset që lidhen me investimet.

Në aspektin e teknologjisë financiare Grupi i Thesarit dhe Istitucioneve Financiare nënshkroi një marrëveshje me një shoqëri me reputacion të lartë në të gjithë botën dhe nisi një projekt tjetër revolucionar për Shqipërinë, përmes së cilit klientët e BKT-së mund





të investojnë pa kufij në aksione, indekse, mallra ndërkombëtare dhe në produkte të tjera investimi përmes një platforme online në celular dhe në internet.

Për shkak të rritjes së kërkesave rregullatore dhe kostove të KYC/AML (njihni klientin tuaj dhe masat kundër pastrimit të parave), disa banka korrespondente u tërhoqën nga ofrimi i shërbimeve në vendet e vogla të rajonit të Ballkanit, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Megjithatë, falë reputacionit të padiskutueshëm të BKT-së në tregjet

financiare ndërkombëtare, Grupi i Institucioneve Financiare dhe i Thesarit zëvendësoi me sukses ato banka korrespondente që u larguan me banka të reja.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, si pjesë e strategjisë së zgjerimit të BKT-së, Departamenti i Institucioneve Financiare prezantoi raportin e tij të fizibilitetit dhe nisi aplikimin për të zgjeruar aktivitetin e bankës në një vend aziatik. Plani i zgjerimit pritet të realizohet pas marrjes së miratimit nga autoritetet qeveritare dhe nga Banka e Shqipërisë.





# GRUPI I MENAXHIMIT TË RISKUT

SISTEMI BANKAR NË SHQIPËRI VIJOI TË ZGJEROHET DHE TË TREGOJË NJË SITUATË POZITIVE FINANCIARE NË VITIN 2018. NORMA E ZGJERIMIT TË AKTIVEVE ISHTE MË E NGADALTË KRAHASUAR ME NJË VIT MË PARË, E KUSHTËZUAR KJO NGA KREDITË PËR KORPORATA. NË NJË KËNDVËSHTRIM POZITIV, CILËSIA E AKTIVEVE ËSHTË PËRMIRËSUAR GRADUALISHT POR NË MËNYRË TË DUKSHME, SIÇ VIHET RE NGA RËNIA E RAPORTIT TË KREDIVE TË KËQIJA (NPL) NDAJ TOTALIT TË KREDIVE, ME NJË RËNIE NGA 13.2% NË FUND TË VITIT 2017 NË 12.7% NË NËNTOR 2018.

Viti 2018 shënoi një moment të rëndësishëm në historinë e sistemit bankar shqiptar, pasi përpjekjet e konsolidimit të nisura disa vite më parë rezultuan të suksesshme. Si rezultat i konsolidimit numri i bankave në treg u ul nga 16 në 14. Krahas këtij ndryshimi, pati ndryshime edhe në origjinën e kapitalit.

BKT beson se pas këtij zhvillimi të rëndësishëm të tregut, konkurrenca midis bankave do të rritet. Bankat do të jenë më të përkushtuara që tu ofrojnë grupeve të tyre të synuara produkte më të mira me çmime dhe shërbime konkurruese, duke përmirësuar kështu avantazhet e tyre konkurruese. Për më tepër, bankat mund të kenë edhe më shumë stimuj për tu zgjeruar dhe zhvilluar në fusha të reja biznesi. Në këtë këndvështrim, një strukturë efektive dhe efikase e menaxhimit të rrezikut do t'i shtonte vlerë avantazheve konkurruese të bankës. Menaxhimi i rrezikut në BKT po punon me dedikim për t'u përballur me sfidat e reja të ofruara nga tregu.

Pavarësisht ndryshimeve dhe zhvillimeve të tregut, BKT-ja vijon të jetë lider në sistemin bankar për sa i përket treguesve të performancës së biznesit, duke ruajtur pozita të qëndrueshme lidhur me cilësinë e aktiveve, mbulimin

me likuiditet dhe kapital. Roli i Menaxhimit të Rrezikut ka qenë thelbësor në të gjitha këto arritje të bankës.

Grupi i Menaxhimit të Rrezikut për menaxhimin e cilësisë së aktiveve, një nga treguesit më kritik për bankat, është fokusuar në dy drejtime: menaxhimi i kredive të këqija dhe mirëmbajtja e aktiveve me cilësi të lartë. Gjatë vitit 2018, BKT në Shqipëri ka ruajtur pozicionin lider për performancën e kredive të këqija, ku raporti i NPL-ve 90-ditore arriti në 4.60% në fund të vitit, një rënie me rreth 51 pikë bazë krahasuar me vitin 2017. Përveç kësaj, kemi rritur përpjekjet tona në procesin e menaxhimit dhe shitjes së aktiveve të sekuestruara përmes procesit të ekzekutimit të kolateralit, e gjitha kjo e pasqyruar në strategjinë e miratuar të Bankës.

Në përputhje me përgjegjësitë funksionale, Grupi i Menaxhimit të Rrezikut ishte grupi kryesor përgjegjës në Procesin e Vet-vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Planeve të Rimëkëmbjes. Vlerësimi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të Brendshëm, i përcaktuar si shtylla e dytë e kuadrit të Bazelit për mjaftueshmërinë e kapitalit, është një proces që i jep Bankës mundësinë të vlerësojë më mirë rreziqet kryesore me të cilat përballet



dhe të shpërndajë kapitalin bazuar në këtë vlerësim. Qëllimi i Procesit të Vetvlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është identifikimi i të gjitha burimeve kryesore të rrezikut ndaj të cilave BKT-ja është e ekspozuar. Kjo analizë mbulon jo vetëm burimet klasike të rrezikut për institucionet financiare, si p.sh. rreziqet e kredisë, e tregut dhe operacionale, por gjithashtu merr parasysh rreziqet strategjike, e biznesit dhe reputacionin - ku kjo e fundit paraqet më shumë sfida në procesin e identifikimit dhe modelimit. Bazuar në nivelin e rrezikut, merren vendime lidhur me kapitalin që duhet shpërndarë. Duke qenë se ky proces i përshtat kërkesat e kapitalit me rreziqet dhe kthimet e linjave të biznesit, ai do të shërbejë si udhëzues i rëndësishëm gjatë hartimit të objektivave strategjike dhe planeve të biznesit.

Viti 2018 gjithashtu shënoi arritje të rëndësishme në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit, sa i përket aktiviteteve të kryera për parandalimin e pastrimit të parave dhe menaxhimit të rrezikut të financimit të terrorizmit (AML/CFT). Në mënyrë specifike, për sa i përket monitorimit, analizës, parandalimit dhe raportimit të transaksioneve, zbatimi i programit Siron TONBELLER ka ofruar një zgjidhje efikase për të parandaluar rreziqet dhe ngjarjet e pastrimit të parave në çdo kohë dhe në çdo fazë. Modulet specifike kryejnë klasifikimin fillestar dhe të vazhdueshëm të rrezikut të klientëve të rinj dhe atyre ekzistues dhe mundësojnë ushtrimin e kujdesit të duhur në sistemin e kërkimit. Sinjalet paralajmëruese për mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të pastimit të parave të gjeneruara nga sistemi bazohen në të dhënat

e klientit dhe në cilësimet e personalizuara të bazuar në rrezik, ndërkohë që funksionaliteti i menaxhimit të rasteve mbështet proceset e vendimmarrjes me qëllim raportimin e aktiviteteve të dyshimta (SAR) tek autoritetet përgjegjëse.

MONEYVAL, i cili është institucioni përgjegjës në Këshillin e Evropës për parandalimin e pastrimit të parave si dhe një institucion i rëndësishëm ndërkombëtar për vlerësimin e efektivitetit të masave të vendosura për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, ka publikuar një raport pozitiv lidhur me veprimtarinë e bankave të nivelit të dytë në Shqipëri për sa i përket parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë raport, MONEYVAL përgëzon bankat në Shqipëri, të cilat kanë provuar se disponojnë një nivel të lartë ndërgjegjësimi për rreziqet ML/FT dhe zbatojnë siç duhet masat zbutëse<sup>1</sup>, në një kohë kur mekanizmat e monitorimit në “nivel kombëtar” kanë treguar se nuk janë plotësisht efektive.

Sa i përket rrezikut të përputhshmërisë, BKT zbaton një qasje të decentralizuar për të rritur përgjegjësinë e linjave të biznesit, duke zvogëluar nevojën e monitorimit dhe duke u përpjekur që rreziku i përputhshmërisë të mos trajtohet si “problemi i dikujt tjetër”. Në këtë kuadër, secili drejtues departamenti/dege dhe punonjës duhet të ndërmarrë aktivitete të vazhdueshme të monitorimit të përputhshmërisë në fushat e veta të kompetencës. Këto aktivitete janë të strukturuar dhe udhëhiqen nga funksioni i menaxhimit të rrezikut të përputhshmërisë me qëllim arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Në kontekstin e menaxhimit të rrezikut ligjor, ndryshimet në legjislacion monitorohen me qëllim që banka të sigurojë ushtrimin e veprimtarisë së saj të përgjithshme në përputhje me normat ligjore në fuqi. Për më tepër, ky proces mbështet zgjerimin e aktivitetit të Bankës jashtë vendit dhe transformimin e BKT Kosovës nga degë në filial. Fokusi i veçantë gjatë këtij viti u vendos mbi transparencën dhe mbrojtjen e të dhënave, dy aspekte thelbësore që rregullojnë veprimtarinë e bankës në raport me palët e interesit. Lidhur me transparencën, u përditësuan të gjitha kontratat e kredive për individë dhe për korporata, ndërkohë që nga ana tjetër u hartua një paketë e plotë rregullatore e brendshme që rregullon mbrojtjen e të dhënave.

Përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit ligjor, si një fazë paraprake e zbutjes së rrezikut ligjor, kanë vazhduar të rrisin kulturën ligjore brenda bankës nëpërmjet publikimit dhe zbatimit të procedurave ligjore, praktikave dhe proceseve, sinjalizimeve dhe trajnimeve.

Gjatë vitit u krijuan dhe u ruajtën marrëdhëniet me institucionet qeveritare dhe organet profesionale. Në këtë kontekst, vlen të përmendet roli këshillues në projekt-direktivën që lidhet me Direktivat e Tarifave të Përmbartimit, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm në kostot administrative të portofolave me performancë jo të mirë në sistemin bankar.

<sup>1</sup>Këshilli i Evropës, MONEYVAL (2018) Rekomandimi 7, “Masat kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit në Shqipëri”, Raporti i Pestë i Vlerësimit të Ndërsjellë, korrik 2018.



**B**KT, banka lider në Shqipëri dhe njëkohësisht pioniere në përfaqimin e risive më të fundit dhe përshtatjen ndaj teknologjive novatore, gjithmonë ka synuar arritjen e ekselencës në shërbimet që ofron për klientët e saj. Në këtë këndvështrim, Teknologjia e Informacionit është konsideruar vazhdimisht si një shtyllë dhe partner i konsoliduar në hartimin e udhërrëfyesit strategjik të bankës.

Viti 2018 nuk përbën asnjë përjashtim nga kjo traditë; ky vit dëshmoi hapa gjigant drejt transformimit digjital të bankës, me mbi 7.5 milionë euro në CAPEX dhe OPEX dedikuar sistemeve dhe projekteve të TI-së, duke përfshirë edhe BKT Kosovën, ndërsa për vitin 2019 pritet një rritje prej 30% në këto investime.

Së fundmi, sistemi i thesarit i zbatuar rishtazi ofron procesim automatik - STP të plotë në kohë reale në të gjitha klasat e aktiveve, nga shitjet me çmim të paracaktuar deri te ato më komplekset. Ky sistem eliminon hedhjen e të dhënave të tepërta, duke kursyer më shumë kohë dhe duke eliminuar gabimet. Sistemi është i pajisur me një modul të integruar të zyrës operacionale, i cili jo vetëm garanton mbështetjen e duhur për zyrën kryesore, por gjithashtu ofron fleksibilitet në përcaktimin e çdo procedure të STP. Po ashtu, ky sistem e fuqizon më tej BKT-në përmes një moduli të përshtatshëm të rrezikut për mbikëqyrjen e operacioneve të përditshme, përbushjen e kërkesave rregullatore dhe marrjen e njohurive të nevojshme për të optimizuar biznesin.

Gjatë vitit 2018, kemi përfunduar zbatimin dhe integrimin e plotë të një zgjidhjeje të avancuar TI-je për të parandaluar në mënyrë efikase rreziqet dhe ngjarjet e pastrimit të parave në të gjitha fazat dhe në çdo kohë. Transaksionet kontrollohen dhe verifikohen me listat e sanksioneve dhe “ngrihen” automatikisht nga sistemi nëse gjendet ndonjë përputhje me qëllim parandalimin e ndonjë transferte të mundshme apo ndryshimet e pronësisë.

Sistemi ynë është pasuruar me shumë rregulla të personalizuar për të mbuluar të gjithë skenarët e pastrimit të parave.

Kohët e fundit, sektori bankar është përballur me ndryshime të shpejta dhe të përhershme që përfshijnë teknologjinë, sjelljen e konsumatorëve dhe rregullatorë, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë mbështetjen e bankave në procese standarde. Për të trajtuar më mirë këto sfida, BKT vazhdon të jetë e përkushtuar

për të kryer investime në sistemet më të mira të BPM (Menaxhimi i Proceseve të Biznesit), të cilat ndihmojnë bankën të lidhë proceset operacionale me objektivat dhe strategjitë e biznesit. Aktualisht, fokusi është përqendruar në automatizimin e proceseve të biznesit, si dhe në lehtësimin dhe përshtetimin e proceseve të vendimmarrjes për huadhëniet, nëpërmjet një sistemi të dedikuar të vendimmarrjes për kreditë si dhe integrimin online në platformat shtetërore elektronike.

Rëndësia e përshtatjes së bankingut elektronik jo vetëm në mbarë botën, por edhe në Shqipëri, ka ndihmuar BKT-në të ruajë vazhdimisht fokusin në kanalet e saj online, jo vetëm duke i pasuruar ato shpesh me produkte dhe shërbime të reja, por edhe duke i rikonceptuar ato herë pas here në mënyrë që të përbushen dhe të tejkalohen pritshmëritë e ndryshueshme të klientëve të cilët kërkojnë nivele më të larta të shërbimeve në drejtim të mundësisë, fleksibilitetit, lehtësisë dhe efektivitetit.

Nuk mbeten pas as klientët që vizitojnë degët tona. Në pjesën më të madhe të degëve tona, është instaluar një sistem inteligjent i menaxhimit të radhës për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe që klientët të ndihen komodë dhe të lumtur.

Me shfaqjen e teknologjive të reja, mjedisi kërcënuar i sigurisë së informacionit do të vazhdojë të ndryshojë. Për rrjedhojë, duhet të zbatohen përmirësime të vazhdueshme për të rritur sa më shumë efektivitetin e burimeve të BKT-së, për ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe për të siguruar që kapacitetet e sigurisë së informacionit të bankës të mbeten të forta.

Për të përbushur këtë objektiv të rëndësishëm kërkohet një strategji universale me elementë mbështetës e gjithëpërfshirës, përmes të cilës, pavarësisht ndryshimeve të shpejta dhe proceseve të digjitalizimit të ndërmarra nga BKT, banka ka menaxhuar më së miri sulmet e ndryshme. Për rrjedhojë, BKT mbetet gjithmonë e angazhuar në trajtimin dhe minimizimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit duke synuar pajisjen me programe konkrete dhe të vazhdueshme për mbrojtjen e informacionit dhe mekanizma për të garantuar disponueshmërinë, konfidencialitetin dhe gadishmërinë e aseteve të informacionit të BKT-së.

Ekspertiza jonë bazohet në një përvojë shumëvjeçare dhe po ashtu është çertifikuar nga organizatat lider në





fushën e TI-së dhe Sigurisë së Informacionit, si p.sh. ISACA, ISO, CompTIA, Akademia CQURE, dhe të tjera. Personeli ynë është tejet i përgatitur profesionalisht në përqafimin e praktikave të TI-së dhe sigurisë së TI-së në harmoni të plotë me standardet më të mira, duke rezultuar me përgjigje në kohë reale ndaj rreziqeve që lidhen me sigurinë e informacionit. Gjithashtu, siguria jonë e informacionit i përmbush të gjitha kërkesat ligjore, kontraktuale dhe rregullatore të biznesit.

Ne vazhdimisht synojmë rritjen sistematike të qasjes së bankës lidhur me sigurinë e informacionit, duke zhvilluar vazhdimisht trajnime dhe konsultime të përbashkëta në të gjithë organizatën, me qëllim pajisjen e personelit tonë me njohuritë e nevojshme për të trajtuar kërcënimet dhe dobësitë.

Që nga viti 2017, BKT ka vënë në zbatim mekanizmin e Transferimit të Çmimit të Fondeve (FTP), i cili i mundëson bankës shpërndarjen e fondeve në mënyrë të drejtë dhe të paracaktuar, duke përfituar kështu një pamje më të qartë të kontributit individual të produkteve në marzhin total të interesit neto. Mekanizmi FTP është pjesë e sistemit të përfitueshmërisë së zbatuar nga banka, duke llogaritur me saktësi maksimale përfitueshmërinë e degëve, linjave të biznesit, produkteve, shërbimeve, segmenteve deri në nivel klienti dhe llogarie individuale, duke i mundësuar bankës përcaktimin dhe ndjekjen e objektivave në baza përfitueshmërie. Ky sistem gjithashtu mundëson shpërndarjen e burimeve drejt aktiviteteve përkatëse dhe më pas drejt produkteve që përfitojnë nga këto aktivitete. Në vitin 2018, BKT-

ja përqendroi përpjekjet e saj në mirëmbajtjen, përmirësimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të sistemit, duke trajtuar nevojat e biznesit.

Adoptimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë është një vendim strategjik për një organizatë që mund të përmirësojë performancën e saj dhe të garantojë një bazë të shëndoshë për nismat e zhvillimit të qëndrueshëm. Për të garantuar që produktet dhe shërbimet e saj të përmbushin vazhdimisht kërkesat e klientëve dhe që cilësia përmirësohet vazhdimisht, BKT ka përfituar dhe zbatuar certifikimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 900:2015. Ky standard i ri bazohet në disa parime të menaxhimit të cilësisë, me fokus të veçantë klientin, motivimin dhe përfshirjen e drejtuesve të lartë, qasjen sistematike, dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Falë investimeve të vazhdueshme në sisteme dhe në burime njerëzore, BKT ka ruajtur gjithmonë një standard dhe cilësi shumë të lartë në aktivitetet e saj të planifikimit financiar dhe raportimit. Pas privatizimit në vitin 2000, BKT publikon në mënyrë priodike pasqyra financiare të audituara sipas SNRF. Përveç kësaj, pas zbatimit me sukses të kërkesave të Kodit Shqiptar të Qeverisjes së Korporatave dhe të kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë, performanca e përgjithshme financiare e BKT-së, politikat e shpërndarjes së fitimit dhe raportet e nevojshme të përputhshmërisë janë tashmë transparente dhe të aksesueshme në çdo kohë nga të gjitha palët e interesit.



## I JAPIM RËNDËSI TË JASHTËZAKONSHME BURIMIT TONË MË TË ÇMUAR: KAPITALIT NJERËZOR.

Punonjësit tanë kanë rëndësi kritike për suksesin tonë. Treguesit Kryesorë të Performancës të Kapitalit Njerëzor kanë ruajtur një trend shumë pozitiv gjatë viteve, ku BKT vazhdon të mbetet në krye të tregut bankar shqiptar (duke përfshirë edhe vitin 2018). Kjo ka përforcuar përkushtimin tonë ndaj të ardhmes së BKT-së. Profesionalizmi i punonjësve, menaxhimi i talenteve, zhvillimi i karrierës, lidershipi, planifikimi i vazhdimësisë, motivimi dhe përkushtimi përbëjnë prioritetet tona kryesore që banka të mbetet banka më e mirë në tregun shqiptar. Në arritjen e këtij objekti, ne jemi fokusuar në nxitjen e një kulture në të cilën punonjësit tanë ndihen të vlerësuar, besimplotë për të shkëmbyer pikëpamjet e tyre dhe të aftë për të përmbushur potencialin e tyre.

Fokusi i bankës vazhdon të mbetet trajnimi intensiv i forcës punëtore për të formuar profesionalisht punonjës që mund të kryejnë disa funksione njëkohësisht, për të nxitur produktivitetin dhe efikasitetin e stafit, duke u fokusuar në tërheqjen e talenteve, zhvillimin e punonjësve, motivimin, angazhimin dhe mbajtjen e tyre. Më 31 dhjetor 2018, numri i punonjësve të BKT-së ishte 934.

## INFORMACIONE TË RËNDËSISHME PËR KAPITALIN NJERËZOR TË BANKËS:

**Arsimimi:** Gëzojmë një forcë punëtore të mirë-arsimuar, ku 97% kanë diplomë universitare; 32% e tyre kanë një diplomë master.

**Gjinia:** Punonjëset femra përfaqësojnë 73% total të stafit, 63% të drejtuesve të nivelit të mesëm dhe 20% të anëtarëve të bordit dhe drejtuesve ekzekutiv.

**Mosha mesatare:** Mosha e forcës punëtore të BKT-së mbetet

e re; 33 është mosha mesatare, dhe 82% janë brezi i mijëvjeçarit të ri.

**Kohëzgjatja mesatare e shërbimit:** 7.3 vite (me rritje)

**Norma totale e mbajtjes së punonjësve:** 89%

Për shkak të kontributit në kapitalin njerëzor, në vitin 2018 banka u nderua përsëri me çmimet më të rëndësishme të industrisë bankare ndërkombëtare. Këto çmime motivojnë, frymëzojnë dhe rrisin përgjegjësinë dhe profesionalizmin e punonjësve tanë kundrejt klientëve, shoqërisë dhe aksionarëve, ndërkohë që ne ruajmë ende pozicionin tonë si banka më e mirë.

## TËRHEQJA E TALENTEVE

Tërheqja dhe mbajtja e talenteve mbetet një nga qëllimet më të mëdha të bankës. Strategjia jonë e rekrutimit është fokusuar në tërheqjen e punonjësve të talentuar dhe të kualifikuar, gjetjen e personave të duhur dhe pozicionimin e tyre në rolet e duhura. Po ashtu, qasja jonë e rekrutimit synon të përshtatet sa më mirë me kulturën e bankës sonë, jo vetëm për aftësitë teknike por edhe për zgjedhjen e personave me qëndrimin dhe vlerat e duhura. Banka përdor kanale të shumta për të përthithur kandidatët potencialë, duke përfshirë publikimin e njoftimeve për punë në faqen tonë të internetit, vendosjen e kontakteve me kandidatët përmes pjesëmarrjes në panairë pune dhe ditët e karrierës, marrëdhëniet e ngushta me universitetet, publikimin e njoftimeve për vende të lira pune në portalet e dedikuara për njoftime për vende pune, në faqet e medias sociale bankës, etj.

Njoftimet për vendet e lira të punës të BKT-së janë pjesë përbërëse e strategjisë së zhvillimit të kapitalit njerëzor të bankës, duke u dhënë punonjësve mundësinë të rriten brenda bankës dhe të përballen me sfida dhe përvoja të



reja, për të kuptuar potencialin dhe zhvillimin e karrierës brenda bankës përmes një procesi të drejtë konkurrues. Për njëmbëdhjetë vite radhazi, BKT vijoi mbështetjen e saj për Partneritetin Publiko-Privat me Universitetin e Durrësit dhe studentët e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktika (FASTIP). 11% e forcës punëtore të bankës i përket FASTIP. Banka vazhdon të ofrojë praktika pune për studentët më të mirë, duke ndihmuar kështu brezin e ri të rrisë njohuritë e tyre bankare përmes praktikës dhe duke i përgatitur ata për tregun e punës dhe punësimin në të ardhmen.

## MENAXHIMI I PERFORMANCËS DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE

Përmes procesit të menaxhimit të performancës, punonjësit tanë njihen me objektivat e tyre dhe pritshmëritë për rolin e tyre. Punonjësit kanë një plan performance që i ndihmon ata të përqendrohen në objektiva specifike të funksionit të tyre në institucion, duke përfshirë edhe objektivat që mbështesin kulturën tonë. Menaxhimi i performancës luan një rol të rëndësishëm në rritjen e performancës së bankës, në mënyrë që të gjithë e kuptojnë kontributin e tyre në qëllimet dhe objektivat organizative, që punonjësit të kuptojnë se çfarë pritet prej tyre dhe njëkohësisht të kenë aftësitë dhe mbështetjen e duhur për të përmbushur këto objektiva. Zbatimi i politikave të përshtatshme të Burimeve Njerëzore ka rritur angazhimin dhe sigurojnë komunikim efektiv në të gjithë bankën, duke lidhur objektivat me shpërblimin dhe kompensimin e punonjësve.

Ne e kemi përkthyer strategjinë e Bankës në një qasje zhvillimi që përfshin vlerat dhe besimet tona në praktikën e punonjësve tanë përmes:

- Ndërtimit të kapaciteteve në të gjithë bankën, me praktika të drejta dhe plot mundësi për progres në karrierë në të ardhmen, duke përfshirë programet e leadershipit për planifikimin e vazhdimësisë.
- Krijimi i një mjedisi që nxit performancën e qëndrueshme në përputhje me strategjinë e bankës.
- Investimi në zhvillimin profesional dhe personal të punonjësve tanë për t'i motivuar, për të maksimizuar aftësitë e tyre, dhe të kontribuojnë në performancën individuale dhe organizative.

Gjatë këtij viti, 22% e stafit tonë u promovua në pozicione pune më të larta/ ndryshoi pozicionin bazuar në performancën e tyre të suksesshme, ekspertizën dhe kapacitetet e tyre. Në vitin 2018, 94% e punonjësve tanë morën pjesë në trajnime të ndryshme të zhvilluara brenda bankës dhe po ashtu 98% e stafit u trajnuar përmes trajnimeve të dërguara me anë të platformës elektronike. Trajnimet tona intensive dhe programet e të mësuarit online mbështesin stafin në ndërtimin e kapaciteteve të tyre, ekspertizën funksionale, leadershipin dhe menaxhimin e ndryshimeve në një mjedis bankar digjital.

## POLITIKA E SHPËRBLIMIT

Cilësia dhe përkushtimi i punonjësve të bankës është një nga pikat më thelbësore të suksesit tonë, pasi gjithmonë synimi ynë është të tërheqim, mbajmë dhe motivojmë punonjësit më të mirë. Praktikën tonë të shpërblimit nxisin punonjësit të kenë karrierë afatgjatë në bankë. Strategjia jonë është projektuar që arrijtjet të shpërblehen në mënyrë konkurruese, tërheqja e talenteve dhe motivimi i punonjësve më të mirë.

## NE I DËGJOJMË PUNONJËSIT TANË

Për ne ka shumë rëndësi që të kuptojmë se si ndihen punonjësit për bankën. Çdo vit, BKT-ja ka kryer anketa periodike për të matur kënaqësinë dhe angazhimin e punonjësve dhe për të mbledhur opinionet e tyre. Rezultatet i përcillen stafit drejtues të bankës dhe ne marrim masat bazuar në reagimet e punonjësve. Kjo na ndihmon të sigurohemi që jemi duke i dhënë punonjësve mbështetjen e duhur për të rritur potencialin e tyre dhe për t'i shërbyer klientëve tanë.

## RRITJE PERFORMANCE NË BURIME NJERËZORE

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore përdor SAP për funksione të tilla si rekrutimi online, performanca, menaxhimi i pagave dhe kompensimeve, të mësuarit online, etj. Nëpërmjet SAP Employee Self Services (ESS) dhe Manager Self Services (MSS), punonjësit tanë mund të kryejnë vetë shumë procese të menaxhimit të burimeve njerëzore. Qëllimi ynë është që gjatë punës së përditshme, menaxherët dhe punonjësit tanë të marrin mbështetjen e duhur përmes një sistemi efektiv dhe eficient të burimeve njerëzore. Matja në mënyrë periodike e Treguesve Kyç të Performancës (KPI) të burimeve njerëzore është fokusi jonë si një mënyrë kritike për matjen dhe vlerësimin e vlerave të burimeve njerëzore, diagnostikimin e problematikave dhe përshtatjen e strategjive për një progres të qartë për tre grupet e matjeve: produktiviteti i punonjësve, qëndrueshmëria dhe efijensa operacionale e burimeve njerëzore.

## ANGAZHIMI, SHËNDETI DHE MIRËQENIA, DHE AKTIVITETET SOCIALE

“Programi për Mirëqenien, Angazhimin dhe Aktivitetet Sociale” është zhvilluar përgjatë gjithë vitit, me qëllim motivimin dhe rritjen e angazhimit dhe përfshirjes së punonjësve përmes një kalendari aktivitetesh mujore.

Ndër aktivitetet kryesore gjatë vitit 2018 përfshijnë mirënjohje për performuesit më të mirë të vitit, “Friday Happy Hours”, organizimi i Festës së Fëmijëve të punonjësve tanë, mirënjohje për fituesit e “Dega më e mirë e Tremujorit” dhe një aktivitet dedikuar punonjësve me vjetërsi dhjetë vjeçare në bankë. Ndër aktivitetet e tjera vullnetare të stafit tonë përfshihen dhurimi i gjakut nga punonjësit, mbështetja për Fondacionin Down Syndrome Albania dhe aktivitete sportive si p.sh. pjesëmarrja e punonjësve në Maratonën e Tiranës. Këto aktivitete kanë pasur një ndikim të madh në angazhimin, përfshirjen dhe motivimin e stafit.





**Gjithmonë**





kontribuojmë



**B**ANKA KOMBËTARE TREGTARE ËSHTË PËRHERË E VETËDIJSHME PËR NDIKIMIN QË KORPORATAT E MËDHA KANË NË TË GJITHA ASPEKTET E SHOQËRISË, DUKE PËRFSHIRË EFEKTET E TYRE NË EKONOMI, SHOQËRI DHE MJEDIS. NDËRSA KËRKOJMË MË TË MIRËN PËR TË GJITHA PALËT TONA TË INTERESIT, NJËKOHËSISHT KËRKOJMË EDHE QË TË JEMI TË PËRJEGJSHËM NDAJ PUBLIKUT. EDHE PSE PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE (CSR) ËSHTË NJË KONCEPT I GJERË, QËLLIMI KRYESOR I BKT-SË ËSHTË TË NXISË NDRYSHIMET NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM, DUKE TRAJTUAR TEMA TË SHUMTA SI QEVERISJA E KORPORATAVE, FILANTROPIA, VULLNETARIZMI, SHËNDETI DHE SIGURIA, EFEKTET MJEDISORE DHE KONTRIBUTET NË ZHVILLIMIN EKONOMIK.

KONTRIBUTI I BKT-SË PËR PALËT TONA TË INTERESIT DHE PËR SHOQËRINË SHQIPTARE NË TËRËSI ËSHTË NË PËRPTHJE ME OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (SDG) TË PËRCAKTUARA NË AGJENDËN E 2030 TË OKB-SË. NË PËRPTHJE ME SHTYLLAT KRYESORE TË FILOZOFISË SË PËRGJEGJËSISË SOCIALE TË KORPORATAVE TË BANKËS, AKTIVITETET KRYESORE TË BKT-SË GJATË VITIT 2018 ISHIN:

## Q E V E R I S J A

Qeverisja Korporative e BKT-së synon të jetë në përputhje të plotë me legjitimitetin dhe teorinë e palëve të interesit, të cilat mund të konsiderohen si plotësuese të njëra-tjetrës. Sistemet, parimet dhe proceset ku mbështetet banka jonë ofrojnë udhëzime se si BKT-ja drejtohet ose kontrollohet në mënyrë që qëllimet dhe objektivat tona të përmbushen për ti shtuar sa më shumë vlerë institucionit. Ne veprojmë në përputhshmëri të plotë me Kodin Shqiptar të Qeverisjes së Korporatave dhe respektojmë Parimet e Qeverisjes së Korporatave të OECD-së, njëkohësisht duke marrë të gjitha masat e duhura që të gjithë aktorët e përfshirë të kenë përfitime afatgjata. Për më tepër, vlerësimi i vazhdueshëm i "JCR Eurasia Rating" me "AAA (Alb)/Distinctive" për BKT-në nënkupton një nivel të veçantë të përputhshmërisë me parimet e kodit.





## PUNËSIMI

Ndërkohë që pjesa më e madhe e hulumtimeve të përgjegjësisë sociale të korporatave (CSR) fokusohen tek aktorët e jashtëm, punonjësit janë thelbi i bankës sonë, pasi puna dhe përpjekjet e tyre janë burimi kryesor i suksesit tonë. Angazhimi, vlerësimi dhe përkushtimi i ndërsjellë gjatë viteve kanë nxitur respekt të brendshëm të ndërsjellë tek të gjitha palët. BKT-ja ka promovuar gjithmonë punësimin produktiv dhe punën e denjë, duke vepruar në përputhje me shtyllat kryesore të PSK-së në Agjendën 2030. Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës, trajnimi periodik i punonjësve, mbrojtja sociale me barazi gjinore dhe zbatimimi i praktikave bashkëkohore për menaxhimin e burimeve njerëzore pasqyrojnë disa nga nismat më të suksesshme të bankës sonë.



Një nga projektet që reflekton përpjekjet tona të vazhdueshme për të krijuar vlerë për shoqërinë tonë është partneriteti ynë me Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës. Gjatë viteve, banka ka sponsorizuar 184 studentë, 37 studentë ende ndjekin vitin e fundit akademik, ndërsa 126 të diplomuar janë bërë menjëherë pjesë e stafit tonë. Me krenari mund të themi se sot 11% e punonjësve të BKT-së janë bërë pjesë e rrugëtimit tonë nga ky projekt.





# S H O Q Ë R I A

Për BKT-në, përgjegjësia sociale e korporatave është shumë më shumë se një mundësi për publikimin e një fotografie. Në të përfshihet një strategji e mirë-planifikuar në përputhje të plotë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien publike, duke synuar balancën e duhur mes rritjes së qëndrueshme dhe efijencës, dhe duke krijuar vlera afatgjata për shoqërinë në tërësi.

BKT-ja është gjithnjë në kërkim të mundësive, duke ofruar mbështetjen e saj për përmirësimin e kushteve të punës në institucionet publike. Gjithashtu, ashtu siç kemi bërë për shumë vite me radhë, edhe gjatë 2018 mbështetëm një sërë veprimesh dhe ngjarjesh përmes filantropisë dhe nismave vullnetare. Ndërkohë, një nga qasjet tona më të dalluara është puna e vazhdueshme ndaj përfshirjes financiare. Përmes shumëllojshmërisë së produkteve dhe shërbimeve të saj, BKT-ja është kujdesur vazhdimisht për personat e përjashtuar financiarisht si p.sh. pensionistët, njerëzit që marrin ndihmë ekonomike nga qeveria, studentët dhe ata që vuajnë dënimin në institucione për ekzekutimin e vendimeve penale.







## M J E D I S I

Qendrueshmëria mjedisore dhe ndryshimet klimatike po kthehen gjithnjë e më shumë drejt parametrave përcaktuese e konkurruese dhe në një shqetësim të përgjithshëm për komunitetin botëror. BKT-ja vazhdon të tregojë përkushtimin e saj të fuqishëm në rritjen e ndërgjegjësimit për mjedisin, duke i dhënë përparësi qëndrueshmërisë mjedisore në të gjitha vendimet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në mjedis. Strategjia jonë për mjedisin bazohet në reduktimin e ndikimit në mjedis përmes planifikimit dhe novacionit, dhe njëkohësisht duke respektuar të gjitha rregulloret mjedisore dhe praktikatat më të mira globale. Synimi ynë është të përmirësojmë konsumin e energjisë dhe të burimeve gjatë prodhimit, duke rishikuar në mënyrë të vazhdueshme proceset tona dhe duke vendosur në zbatim nismat tona (si p.sh. sistemet e ndriçimit eficient ndaj mjedisit, izolimit dhe ngrohjes). Gjithashtu, përgjatë këtyre viteve, BKT-ja ka financuar rregullisht nisma për energjinë e rinovueshme, duke vendosur theksin te projektet e hidrocentraleve si dhe përmirësimet e performancës së energjisë për ndërtesat tregtare dhe të banimit.







# **Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**

**Raporti i audituesit të pavarur dhe  
pasqyrat financiare të konsoliduara  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

# **Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**

**Raporti i audituesit të pavarur dhe  
pasqyrat financiare të konsoliduara  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**



**Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.**

P Ë R M B A J T J A

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA  
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR  
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË  
ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE  
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL  
PASQYRA E KONSOLIDUAR E RRJEDHËS SË PARASË

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

# RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

## Për Aksionerët dhe Bordin Drejtues të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a

### Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a (më tej referuar si “Banka” ose “Grupi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përkrahura në seksion e raportit tonë ‘Baza për Opinionin me Rezervë’, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar të Bankës me datën 31 dhjetor 2018, dhe performancën e konsoliduar financiare dhe flukset e konsoliduara të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin me Rezervë

Banka ka trajtuar kapitalin e vet të emtuar në dollarë amerikanë (USD) si një zë monetar në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe ka njohur diferencat nga rivlerësimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 në fitimet neto në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Ky trajtim nuk është në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 21 “Efektet e ndryshimeve nga kursi i këmbimit”, i cili kërkon që kapitali aksionar të trajtohet si një element jo monetar dhe të mbahet me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Nëse Banka do të kishte trajtuar kapitalin e vet në përputhje me kërkesat e SNK 21, kapitali aksionar më 31 dhjetor 2018 do të rritej me vlerën prej 12,817,771USD, fitimet e paspërndara do të uleshin me vlerën prej 3,883,315 USD dhe fitimi neto do të ulej me vlerën prej 8,934,456 USD më 31 dhjetor 2018. Megjithatë, kjo nuk do të kishte ndikim në vlerën totale të kapitalit aksionar të Bankës.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyrat financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithash-tu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurën auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të

rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të Grupit.

- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- marrim evidence të mjaftueshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar të subjekteve ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të Grupit. Ne jemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

*Kledian Kodra, FCCA*  
*Kodra*



**Grant Thornton sh.p.k.**  
Tiranë, Shqipëri  
20 mars 2019




## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018  
(shprehur në USD)

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>Aktivet</b>			
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	7	285,134,696	295,119,649
Depozita dhe llogari me bankat	8	658,318,886	293,887,630
Investime në letra me vlerë	9	1,486,663,848	1,372,431,232
Hua për bankat	10	195,676,165	424,728,134
Hua për klientët	11	1,215,625,631	1,172,497,193
Investime në pjesëmarrje	12	1,373,165	1,435,525
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	13	41,051,400	38,905,448
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	14	3,700,900	3,080,573
Aktive të tjera	15	53,424,153	57,251,927
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>3,940,968,844</b>	<b>3,659,337,311</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali Aksionar</b>			
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj klientëve	16	3,129,749,851	2,867,899,348
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	17	323,861,645	343,706,001
Detyrime ndaj palëve të treta	18	3,408,125	4,856,919
Detyrime tatimore të shtyra	19	411,719	431,014
Detyrime të tjera	20	20,126,345	21,054,729
Borxhi i varur	21	28,678,547	29,989,497
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>3,506,236,232</b>	<b>3,267,937,508</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar i paguar	22	300,000,000	274,350,310
Rezerva e konvertimit	22	119,742	3,004,286
Rezerva e vlerës së drejtë	22	24,707,662	4,908,867
Fitimi i pashpërndarë	22	109,905,208	109,136,340
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>434,732,612</b>	<b>391,399,803</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar</b>		<b>3,940,968,844</b>	<b>3,659,337,311</b>

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 83, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara u autorizuan nga Këshilli Drejtues më 5 shkurt 2019 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Seyhan Pencabligil  
Drejtor i Përgjithshëm dhe  
Anëtar i Këshillit Drejtues



Skënder Emini  
Drejtor i Grupit të Financës

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Interesi			
Të ardhura nga interesi	23	158,055,738	138,624,420
Shpenzime interesi	24	(27,615,353)	(27,282,800)
<b>Të ardhura nga interesi, neto</b>		<b>130,440,385</b>	<b>111,341,620</b>
Të ardhura të tjera nga veprimtaria bankare, neto			
Tarifa dhe komisione, neto	25	18,029,753	18,623,051
Fitimi neto nga rivlerësimi i instrumentave monetare	26	(6,798,395)	(10,520,992)
Fitimi neto nga këmbimet valutore		(4,766,793)	324,702
Fitimi neto nga tregtimi i investimeve		3,164,176	3,582,910
Shpenzime të tjera, neto	27	(5,688,851)	(3,952,938)
<b>Totali i të ardhurave të tjera neto nga veprimtaria bankare</b>		<b>3,939,890</b>	<b>8,056,733</b>
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	28	(19,731,402)	(18,021,107)
Shpenzime administrative	29	(31,841,144)	(26,302,101)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,14,15	(4,674,689)	(3,855,229)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(56,247,235)</b>	<b>(48,178,437)</b>
Zhvlerësimi i huave	11	(5,837,834)	(1,546,308)
Zhvlerësimi i aktiveve financiare, të ndryshme nga huatë për klientët	30	(1,917,149)	-
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>70,378,057</b>	<b>69,673,608</b>
Tatimi mbi fitimin	31	(11,944,968)	(10,797,108)
<b>Fitimi neto i vitit</b>		<b>58,433,089</b>	<b>58,876,500</b>
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja		(2,884,544)	4,827,893
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë		19,798,795	4,146,365
<b>Te ardhura/(shpenzime) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto pas tatimit</b>		<b>16,914,251</b>	<b>8,974,258</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>75,347,340</b>	<b>67,850,758</b>

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 83, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018  
(shprehur në USD)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva e konvertimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>250,000,000</b>	<b>-</b>	<b>(1,823,607)</b>	<b>762,502</b>	<b>98,400,277</b>	<b>347,339,172</b>
<b>Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital</b>						
<i>Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët</i>	-	-	-	-	-	-
Rritja e kapitalit aksionar	24,350,310	-	-	-	(24,350,310)	-
Pagesë dividend					(30,000,000)	(30,000,000)
Kthimi i diferencave të konvertimit të vitit 2017	-	-	-	-	(1,823,607)	(1,823,607)
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2017	-	-	-	-	8,033,480	8,033,480
<b>Totali i veprimeve me pronarët të regjistruara direkt në kapital</b>	<b>24,350,310</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(48,140,437)</b>	<b>(23,790,127)</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>						
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	58,876,500	58,876,500
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto pas tatimit</b>						
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë	-	-	-	4,146,365	-	4,146,365
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja	-	-	4,827,893	-	-	4,827,893
<b>Totali i humbjeve të tjera gjithëpërf- shirëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,827,893</b>	<b>4,146,365</b>	<b>-</b>	<b>8,974,258</b>
<i>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	-	4,827,893	4,146,365	58,876,500	67,850,758
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>274,350,310</b>	<b>-</b>	<b>3,004,286</b>	<b>4,908,867</b>	<b>109,136,340</b>	<b>391,399,803</b>

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 83, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018  
(shprehur në USD)

	Kapitali aksionar i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva e konvertimit	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>274,350,310</b>	-	<b>3,004,286</b>	<b>4,908,867</b>	<b>109,136,340</b>	<b>391,399,803</b>
<b>Rregullimi për zbatimin fillestar të SNRF9 (shënimi 3, (u))</b>					<b>(6,137,861)</b>	<b>(6,137,861)</b>
<b>Veprimet me pronarët të regjistru- ara direkt në kapital</b>	<b>274,350,310</b>	-	<b>3,004,286</b>	<b>4,908,867</b>	<b>102,998,479</b>	<b>385,261,942</b>
<i>Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët</i>						
Krijimi i rezervës ligjore	-	15,911,492	-	-	(15,911,492)	-
<i>Rritja e kapitalit aksionar</i>	25,649,690	(15,911,492)	-	-	(9,738,198)	-
Pagesë dividend					(30,000,000)	(30,000,000)
Kthimi i diferencave të konvertimit të vitit 2017	-	-	-	-	3,004,286	3,004,286
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2018	-	-	-	-	1,119,044	1,119,044
<b>Totali i veprimeve me pronarët të regjistruara direkt në kapital</b>	<b>25,649,690</b>	-	-	-	<b>(51,526,360)</b>	<b>(25,876,670)</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>						
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	58,433,089	58,433,089
<i>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, neto pas tatimit</i>						
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së drejtë	-	-	-	19,798,795	-	19,798,795
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja	-	-	(2,884,544)	-	-	(2,884,544)
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse</b>	-	-	<b>(2,884,544)</b>	<b>19,798,795</b>	-	<b>16,914,251</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	-	-	<b>(2,884,544)</b>	<b>19,798,795</b>	<b>58,433,089</b>	<b>75,347,340</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>300,000,000</b>	-	<b>119,742</b>	<b>24,707,662</b>	<b>109,905,208</b>	<b>434,732,612</b>

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faja 6 deri në faqen 83, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD)

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>Rrjedha e parave nga aktivitetet operacionale:</b>			
Fitimi para tatimit		70,378,057	69,673,608
Rregullime për të barazuar ndryshimet në aktivet neto me rrjedhën neto të parave nga aktivitetet operacionale:			
Shpenzime interesi	24	27,615,353	27,282,800
Të ardhura nga interesi	23	(158,055,738)	(138,624,420)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	13,14,15	4,674,689	3,855,229
Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara		(35,200)	(14,556)
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		(3,164,176)	(3,582,910)
Fitimi nga shitja e aktiveve të fituara me proces ligjor		(184,498)	(129,457)
Fitimi nga arkëtimi i kredive të fshira të klientëve		(759,007)	(525,277)
Nxjerrje jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara		10,296	21,265
Fshirja e kredive të klientëve		11,556,066	6,296,710
Fshirja e aktiveve të trupëzuara dhe aktiveve të riposduara		94,893	5,600
Provizione për debitorë të tjerë		4,627,031	3,951,143
Pakësimi i fondit të provigjoneve për aktive të përfituara nga procesi ligjor		(222,215)	(66,935)
Lëvizje në rezervën e vlerës së drejtë		17,165,816	3,758,882
Provizione për humbjet nga huatë	11	5,837,834	1,546,308
Zhvlerësimi i aktiveve financiare, të ndryshme nga huatë	30	1,917,149	-
Rrjedha e parave nga fitimet operacionale para ndryshimeve në aktive dhe detyrime operacionale		(18,543,650)	(26,552,010)
(Rritja)/ pakësimi i aktiveve operacionale:			
Llogaritë e kufizuara me bankën qendrore		20,442,632	(47,780,318)
Depozita dhe llogari me bankat		53,702,243	31,406,849
Hua për bankat		211,015,067	(13,580,109)
Hua për klientët		(23,973,389)	(17,158,600)
Aktive të tjera		(1,197,056)	(18,086,100)
		259,989,497	(65,198,278)
Rritja/ (pakësimi) i detyrimeve operacionale:			
Detyrime ndaj klientëve		152,969,982	149,601,436
Detyrime ndaj palëve të treta		(1,394,747)	(497,623)
Detyrime të tjera		(1,938,607)	8,423,045
		149,636,628	157,526,858
<b>Pagesë dividendi, neto</b>		<b>(30,000,000)</b>	<b>(30,000,000)</b>
Interesi i paguar		(28,038,392)	(28,484,877)
Interesi i arkëtuar		156,503,998	135,607,458
Tatimi fitimi i paguar		(11,376,948)	(11,856,656)
<b>Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operacionale</b>		<b>478,171,133</b>	<b>131,042,495</b>
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Blerje e letrave me vlerë		(304,069,823)	(347,469,818)
Investime në pjesëmarrje		92,628	22,967
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(6,044,377)	(20,857,680)
Hyrje nga shitja e aktiveve të trupëzuara		93,782	11,619
Hyrje nga shitja e letrave me vlerë		245,447,727	337,979,653
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>(64,480,063)</b>	<b>(30,313,259)</b>
<b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese</b>			
Hyrje nga huatë afatshkurtra	17	(26,493,022)	22,484,540
Borxhi varur		(1,930,400)	(478,630)
<b>Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese</b>		<b>(28,423,422)</b>	<b>22,005,910</b>
<b>Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të saj</b>		<b>385,267,648</b>	<b>122,735,146</b>
Diferencat në kursin e këmbimit		(10,443,402)	(5,821,523)
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit</b>	7	<b>335,441,946</b>	<b>218,528,323</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	7	<b>710,266,192</b>	<b>335,441,946</b>

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 83, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është një bankë tregtare që ofron një gamë të gjerë me shërbime të plota. Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë Bankën dhe degën e saj në Kosovë (referuar së bashku në vazhdim si “Banka”, “BKT” ose “Grupi”).

Banka ofron shërbime bankare për ndërmarrje shtetërore e private dhe individë. Burimi kryesor i fondeve për Bankën janë depozitat, të cilat Banka i pranon në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozita me dhe pa afat, si në Lek ashtu edhe në valutë. BKT ofron një shumëllojshmëri të kredive për biznese dhe individë, karta krediti dhe debiti në përputhje me standartin EMV (Europay / MasterCard / Visa), bankomate, bankingu në internet, bankingu në telefon celular, shërbime bankingu on-line, shërbim të kualifikuar të bankingut ndërkombëtar dhe produkte të ndryshme thesari. Gjithashtu, ajo investon në letra me vlerë dhe merr pjesë aktivisht në tregun ndërbankar lokal dhe ndërkombëtar.

BKT është krijuar në formën aktuale ligjore më 30 dhjetor 1992, megjithëse dega e saj e parë është hapur më 30 nëntor 1925.

BKT është subjekt i Ligjit nr. 8269 “Mbi Bankën e Shqipërisë” me datë dhjetor 1997 dhe i Ligjit nr. 9662 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006.

Në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 13 gusht 2018, Banka rriti kapitalin e saj të paguar me shumën 2,828,905 mijë Lek (ekuivalente e 25,649,690.3USD) dhe pagoi dividend në shumën 3,308,700 mijë Lek (ekuivalente e 30,000,000 USD), duke përdorur rezervën ligjore prej 1,754,879 mijë Lek (ekuivalente e 15,911,491.92 USD) si edhe një pjesë të fitimit të saj neto të vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe një pjesë të fitimit të pashpërndarë prej 1,074,026 mijë Lek (ekuivalente e 9,738,198.38 USD). Rritja e kapitalit dhe pagesa e dividendit u konvertua në USD me kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datën 13 gusht 2018 (110.29 Lek për USD).

Në vijim të kësaj rritje, struktura aksionare mbeti e njëjtë, me vlerë nominale të aksioneve 12.35 USD, ndërsa numri i aksioneve u rrit me 2,076,898 aksione. Struktura aksionare më datë 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2018			31 dhjetor 2017		
	Nr. i aksioneve	Totali USD	%	Nr. i aksioneve	Totali USD	%
Calik Finansal Hizmetler A.S.	24,291,498	300,000,000.3	100	22,214,600	274,350,310	100

Drejtorja e Përgjithshme e BKT ndodhet në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri, Banka zotëron një rrjet prej 65 degësh dhe 2 agjencish doganore. Njëzet e gjashtë prej degëve ndodhen në Tiranë dhe të tjerat në Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Fier, Pogradec, Korçë, Bilisht, Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë, Orikum, Berat, Kuçovë, Lushnje, Librazhd, Peqin, Rrogozhinë, Shkozë, Kavajë, Vorë, Kamëz, Fushë Krujë, Laç, Lezhë, Rrëshen, Kukës, Peshkopi, Bushat, Koplik, Gramsh dhe Skrapar, të ndjekura nga agjencitë doganore në Portin e Durrësit dhe Aeroportin e Rinasit.

Rrjeti në Kosovë përfshin 26 njësi. Shtatë njësi ndodhen në Prishtinë, ndërsa të tjerat janë të vendosura në Prizren, Peja, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovica, Gjakova, Vushtrri, Fushe Kosova, Podujeva, Drenas, Rahovec, Viti and Lipjan, Dheu i Bardhe, Prishtina Airport and Skenderaj.

Banka kishte 1,292 punonjës (31 dhjetor 2017: 1,292) në datën 31 dhjetor 2018, nga të cilët 358 (31 dhjetor 2017: 348) i përkasin Degës së Kosovës.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 2. Bazat e përgatitjes

#### (a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF').

#### (b) Basis of measurement

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në kosto historike, përveç instrumenteve financiare të gatshme për shitje, të cilët janë matur me vlerën e drejtë.

Për qëllime të raportimit financiar, përlogaritjet e vlerës së drejtë janë grupuar në Nivelet 1, 2 ose 3, bazuar në nivelin e verifikueshmërisë të elementëve të llogaritjes së vlerës së drejtë dhe në rëndësinë e këtyre elementëve në llogaritjen e vlerës së drejtë në tërësi, siç pershkruhet më poshtë:

- Informacionet e përdorura për përlogaritje në Nivelin 1 janë çmimet e tregut të listuara (të pa rregulluara), në një treg aktiv për aktive ose detyrime të njëjta, në të cilat entiteti ka akses në datën e llogaritjes së vlerës së drejtë;
- Informacionet e përdorura për përlogaritje në Nivelin 2 janë të dhëna të ndryshme nga çmimet e listuara në treg të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të verifikueshme për aktivin ose detyrimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte; dhe
- Informacionet e përdorura për përlogaritje në Nivelin 3 janë të dhëna jo të verifikueshme për aktivin ose detyrimin.

#### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në USD. Monedha funksionale e Bankës është Lek Shqiptar ("LEK").

Banka ka zgjedhur t'i prezantojë pasqyrat financiare në USD, meqëse kapitali i saj është i zotëruar plotësisht nga investitorë ndërkombëtarë, të cilët kanë kontribuar kapitalin fillestar në USD dhe e vëzhgojnë performancën e investimit në USD.

#### (d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen si dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elementët e rëndësishëm të pasigurive të vlerësimit dhe mbi gjykimet kritike në përdorimin e politikave kontabël me efekt të rëndësishëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara, jepet në shënimet 4 dhe 5.

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara dhe në mënyrë të njëjtë nga njësitë e Bankës.

#### (a) Baza e konsolidimit

##### (i) Shoqëritë e kontrolluara

Shoqëritë e kontrolluara janë njësi të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqi mbi një njësi ekonomike, është e ekspozuar, ose ka të drejta mbi përfitimet e ndryshueshme nga përfshirja e saj tek njësi, dhe ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj për të ndikuar në përfitimet e njësisë. Banka rivlerëson nëse ka apo jo kontroll mbi një filial, nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime të një ose më shumë nga tre elemente të kontrollit të listuara më lart.

Konsolidimi i një shoqërie të kontrolluara fillon nga momenti kur Banka merr kontrollin mbi shoqërinë e kontrolluar dhe ndalon kur Banka humb kontrollin e filialit. Të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali, të blerë apo shitur gjatë vitit njihen në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nga data kur Banka mer kontrollin deri në datën kur Banka humbet kontrollin mbi njësinë.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (a) Baza e konsolidimit (vazhdim)

##### (i) Shoqëritë e kontrolluara (vazhdim)

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur politika kontabël të njëjta për transaksione të njëjta dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme.

BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë më 3 shtator 2007. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në Prishtinë, Kosovë. Banka Qendrore e Kosovës aprovoi më 30 prill 2018 transformimin në filial të Degës së Kosovës të Bankës Kombëtare Tregtare. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Dega e BKT – së në Kosovë do të mbeten të drejta dhe detyrime të BKT Kosova Sh.A si një filial. Data e shkëputjes së BKT Kosovës është efektive nga data 1 janar 2019. Monedha funksionale është Euro. Efekti i konvertimit të veprimeve në monedhë të huaj në monedhën funksionale të Bankës shpjegohet në shënimin 3.(b).(ii) më poshtë.

##### (ii) Veprimet e eliminuara gjatë konsolidimit

Gjendjet e aktiveve dhe detyrimeve brenda grupit, dhe të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga veprimet brenda grupit (me përjashtim të fitimeve ose humbjeve nga veprimet në monedhë të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e parealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

##### (iii) Kombinimet e Biznesit

Grupi zbaton metodën e blerjes-nëkombinime biznesit. Detyrimi i transferuar nga Grupi për të marrë kontrollin e një shoqërie të kontrolluar llogaritet si shuma e vlerës së drejtë të aktiveve të transferuara, detyrimeve të kryera dhe interesave të kapitalit neto të emetuara nga Grupi, ku përfshihet vlera e drejtë e çdo aktivi ose pasivi që rrjedh nga një marrëveshje kontigjente. Shpenzimet e blerjes njihen mbi bazë konstatimi. Aktivet e blera dhe pasivet e marra në përgjithësi maten në vlerën e drejtë të blerjes.

#### (b) Monedha të huaja

##### (i) Veprimet në monedhë të huaja

Veprimet në monedhë të huaj janë kthyer në monedhën funksionale respektive me kursin e këmbimit të datës kur është kryer veprimi. Aktivet dhe pasivet monetare, të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit i instrumenteve monetare, është ndryshimi midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të periudhës, e regulluar kjo për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, që maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Ndryshimet që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat shprehen me kosto historike, këmbehen me kursin e datës së veprimit, me përjashtim të kapitalit aksionar të paguar, i cili është emetuar dhe mbahet në USD sipas legjislacionit në Shqipëri, dhe në veçanti në përputhje me Ligjin nr. 8634, datë 6 korrik 2000, sipas marrëveshjes ndërmjet aksionerëve të Bankës dhe Republikës së Shqipërisë mbi privatizimin e Bankës.

Për më tepër, Rregullorja e Operacioneve të Bankës kërkon që kapitali aksionar i paguar të mbrohet nga aktivet në USD, dhe prandaj është i trajtuar si një zë monetar, me diferencën e rivlerësimit të kaluar në fitim/humbje së bashku me diferencën e rivlerësimit të aktivitet korrespondues në USD, të cilat kompensojnë njëra-tjetrën në një mënyrë të natyrshme.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (b) Monedha të Huaja (vazhdim)

##### (ii) Operacionet e huaja

Aktivet dhe detyrimet janë të kthyer në Lek me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet janë kthyer në Lek me kursin e datës së veprimit. Diferencat e kursit të këmbimit që lidhen me konvertimin e operacioneve të huaja, janë njohur direkt në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Këto diferenca janë njohur në rezervën e rivlerësimit.

##### (iii) Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit

Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit është si më poshtë:

- aktivet dhe detyrimet në datën e raportimit (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit, i cili është kursi i Bankës së Shqipërisë 1 USD = 107.82LEK (2017: 111.10).
- të ardhurat dhe shpenzimet (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kurset e datës së veprimeve.
- zërat e kapitalit, përveç fitimit neto, kapitalit të paguar dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit.
- kapitali aksionar i paguar është kthyer siç është përshkruar në paragrafin 3(b), (i) më sipër; dhe
- të gjitha diferencat prej kursit të këmbimit janë njohur si një përbërës i veçantë i kapitalit në llogarinë e 'Rezervës së konvertimit'.

##### (iv) Veprimet e shkëmbimit të monedhave të huaja "spot"

Banka, gjatë veprimtarisë normale të biznesit ndërmerr veprime për shkëmbimin e monedhave të huaja ("spot"), për të cilat data e kryerjes është 1 ose 2 ditë pas datës së tregtimit. Këto veprime janë regjistruar në pasqyrat financiare në datën e kryerjes. Diferencat në monedhë të huaj njihen në fitim/humbje në datën e shlyerjes.

#### (c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton saktësisht pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër, kur duhet) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur llogarit normën e interesit efektiv, Banka vlerëson flukset e ardhshme monetare duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo të arkëtuara, që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e veprimeve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

#### (d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Të ardhurat e tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to. Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa veprimesh ose shërbimesh, të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

#### (e) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë operative janë njohur në fitim ose humbje në mënyre lineare gjatë periudhës së qirasë. Zbritjet që ofrohen si nxitje për nënshkrimin e kontratave të qirave, njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë përgjatë jetës së qirasë.

#### (f) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (f) Tatim fitimi (vazhdim)

Banka përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Në 2018, tatimi mbi fitimin është i barabartë me 15% të të ardhurave të tatueshme. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin ligjor para tatimeve për disa të ardhura dhe shpenzime, siç kërkohet në ligjin shqiptar. Fitimi statutor bazohet në të dhënat financiare të mbajtura nga Banka për qëllime rregullatore dhe mund të ndryshojnë nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që kanë raportuar rezultatet financiare. Megjithatë, tatimi aktual i të ardhurave i pagueshëm për vitin 2018 financiar është i barabartë në të dy standardet.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e mëposhtme: njohjen fillestare të emrit të mirë, njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një veprim që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitim/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshëm, dhe diferenca lidhur me investimet në filiale në masën që ato mund të mos i kthejnë këto në të ardhmen. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Në llogaritjen e tatimit aktual dhe të shtyrë Banka merr në konsideratë ndikimin e disa pozicioneve të pasigurta, nëse duhet të llogarisë taksat dhe interesat shtesë. Banka beson që përlllogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë këtu interpretimet e ligjeve tatimore dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në çmuarjen dhe supozimet dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të disponueshme mund të shkaktojnë që Banka të ndryshojë gjykimin e saj mbi përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor të periudhës së kryerjes së këtyre përcaktimeve.

Aktivi tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që do të realizohet fitim i ardhshëm i tatueshëm, në mënyrë që të mund të përdoret kundrejt tij. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet nëse nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Të ardhura të tjera të tatueshme nga shpërndarja e dividendëve, njihen në të njëjtën kohë kur njihet edhe detyrimi për të paguar dividendin

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare

##### (i) Njohja

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen atëherë kur Grupi bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit financiar.

Banka fillimisht njihet huatë, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuar dhe detyrimet e varura në datën kur ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit, në të cilën Banka zotohet të blejë ose të shesë aktivin, me përjashtim të veprimeve të shkëmbimit të monedhave të huaja "spot" të cilat janë njohur në datën e kryerjes (referoju politikës kontabël 3(b) (iv)). Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitet dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare (përveç aktiveve dhe detyrimeve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes) shtohen ose zbriten nga vlera e drejtë e aktiveve ose detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit të lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (ii) Çregjistrimi

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur aktivi financiar, dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen te një palë tjetër.

Detyrimi financiar çregjistrohet atëherë kur ai përfundon, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Banka çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon aktivin financiar, dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit te një palë tjetër. Në qoftë se Banka nuk transferon ose nuk mban kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë aktivin e transferuar Banka vazhdon të njohë interesin e mbartur mbi aktivin dhe pasivin që e shoqëron për shumat që mund të duhet të paguajë. Nëse Banka mbart kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi financiar të transferuar, Banka vazhdon të njohë aktivin financiar dhe gjithashtu njeh një hua të mbuluar me kolateral për shumën e parave të marra. Banka çregjistron detyrimet financiare vetëm, dhe vetëm kur detyrimet e Bankës janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël të pasivit financiar të panjohur, dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Banka merr pjesë në veprime, me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen të gjitha rreziqet dhe përfitimet apo pjesa më e madhe e tyre, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuhet të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe veprimet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një palë të tretë me një normë totale kthimi konvergjuese në kembim të aktiveve, veprimi konsiderohet si një transaksion financiar i siguar, i ngjashëm me veprimet e riblerjes.

Banka çregjistron aktivin kur ajo nuk ka kontroll mbi të, në veprimet ku Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen pas transferimit njihen veçant si aktiv apo detyrim, sipas rastit. Në transferat ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së saj në vazhdimësi, që përcaktohet nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivitetit të transferuar.

Në disa veprime Banka ka detyrimin për t'i shërbyer aktivitetit financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar përfundon së njohuri tërësisht kur plotësohen kriteret e çregjistrimit. Një aktiv apo detyrim përfundon së njohuri për kontratën e shërbimit, varur nga fakti nëse tarifa e shërbimit është më e përshtatshme (aktiv) ose është më pak e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimeve.

Banka bën fshirjen e kredive dhe investimeve kur përcaktohet se ato janë të paarkëtueshme.

##### (iii) Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Aktivitetet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë dhe përshtaten për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme). Aktivitetet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Kosto të amortizuara
- Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL),
- Vlera e Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse ("FVOCI"),

Klasifikimi përcaktohet nga :

- modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar
- karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të aktivitetit financiar.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivitetet financiare njihen në fitim ose humbje

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (iii) Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare (vazhdim)

##### - Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa principali dhe interesi (SPPI)

Sipas standardit të ri, një nga kushtet që aktivet financiare të klasifikohen nën kategorinë “kosto e amortizuar” ose “Vlera e drejtë nëpërmjet fitim humbjeve” (“FVTPL”) është që kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar duhet të përcaktojnë datat e specifikuar të flukseve të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar. Banka ka kryer testin e SPPI dhe ka përcaktuar modelet e biznesit për aktivet e saj financiare.

##### - Vlerësimi i modelit të biznesit

Ekzistojnë tre modele biznesi sipas SNRF 9 – “Të mbajtura për t’uarkëtuar (“HTC”)”, “Të mbajtura për t’uarkëtuar dhe për t’u shitur (“HTCS”)” dhe “Tjetër (“Model Biznesi (MB) tjetër”)”.

1. Sipas modelit HTC, flukset e mjeteve monetare rezultojnë nga mbledhja e pagesave kontraktuale. Nëse një produkt SPPI është HTC, ai matet me koston e amortizuar.
2. Sipas HTCS, flukset monetare rrjedhin nga pagesat kontraktuale, si dhe nga shitja e aktiveve financiare. Nëse një produkt SPPI është HTCS, ai matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (“FVOCI”).
3. MB tjetër janë ato që nuk janë as HTC, as HTCS. Një shembull mund të jetë një model sipas të cilit tregtimi është qëllimi kryesor me arkëtimin e pagesave kontraktuale që nuk përbën një pjesë integrale të modelit. Nëse një produkt (SPPI ose jo) mbahet nën MB tjetër, ai matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (“FVTPL”).

Banka ka vlerësuar modelin e biznesit për aktivet e saj financiare si më poshtë:

##### Thesari

Aktivitetet e thesarit përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, obligacionet qeveritare, letrat me vlerë të investimit të tilla si eurobonde, obligacione dhe çertifikata.

Banka gjithashtu konsideron Kredi për bankat si Kreditë e Sindikuara, Huatë Bilaterale dhe Murabaha si produkte të thesarit. Letrat me vlerë të investimit kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si të mbajtura deri në maturim (“HTM”) ose të vlefshme për shitje (“AFS”) dhe në disa raste si të mbajtura për tregtim (“HFT”).

Modeli i biznesit i Bankës sipas SNRF 9 është:

- “HTC” për produktet HTM. Këto produkte duhet të maten me koston e amortizuar;
- “HTCS” për produktet AFS. Produktet e tilla do të maten në FVOCI; dhe
- “MB tjetër” për produktet HFT dhe duhet të maten në FVTPL.

##### Konsumatore

Aktivitetet konsumatore përbëhen nga linja të ndryshme financimi për individët (p.sh. kredi hipotekore, kredi konsumatore, kredi për përmirësimin e shtëpive, kredi për automjete, karta krediti). Këto produkte janë aktive financiare jo derivate me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe të cilat mbahen për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale të principalit dhe interesave.

Vlera e drejtë e aktiveve konsumatore nuk është një aspekt kritik në menaxhimin e portofolit të Bankës.

Modeli i biznesit i Bankës sipas SNRF 9 është “HTC” dhe kreditë konsumatore maten me koston e amortizuar.

##### Korporatat

Aktivitetet ndaj korporatave përbëhen nga linja të ndryshme financimi për korporatat (p.sh. kreditë me kolateral mjete monetare, kreditë pa kolateral mjete monetare, kreditë agro, projektet e financës së strukturuar, kartat e kreditit të biznesit). Këto produkte janë aktive financiare jo derivate me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe të cilat mbahen për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale të principalit dhe interesave.

Vlera e drejtë e aktiveve ndaj Korporatave nuk është një aspekt kritik në menaxhimin e portofolit të Bankës.

Modeli i biznesit i Bankës sipas SNRF 9 është “HTC” dhe kreditë e korporatave maten me koston e amortizuar.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (iv) Klasifikimi - (periudha krahasuese)

Aktivete financiare klasifikohen në kategoritë e mëposhtme të specifikuar: aktivete financiare të mbajtura për tregtim, investimet e mbajtura deri në maturim, aktivete financiare ‘të vlefshme për shitje’ (AFS), huatë dhe llogaritë e arkëtueshme’. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet ose shitjet e rregullta të mjeteve financiare njihen dhe çregjistrohen në bazë të datës së tregtimit. Blerjet ose shitjet e rregullta janë blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afatit të përcaktuar me rregullim ose konventë në treg.

##### (v) Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

###### *Aktivete financiare me kosto të amortizuar*

Aktivete financiare maten me koston e amortizuar nëse aktivet plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuar si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e aktiveve financiare dhe arkëtimi i flukseve monetare kontraktuale.
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Zbritja nuk konsiderohet ku efekti i zbritjes është jomaterial. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, huatë, dhe shumica e arkëtueshmeve të Grupit bien në këtë kategori të instrumenteve financiare, si dhe obligacione tjeveritare dhe instrumente humbjeje të cilat më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39.

###### *Aktivete financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL),*

Aktivete financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga “të mbajtura për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale” ose “të mbajtura për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale dhe shitur” kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga aktivete financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në (FVTPL). Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës (shih më poshtë). Letrat me vlerë të kapitalit të caktuar u matën me kosto minus çdo zhvlerësim në periudhën krahasuese sipas SNK 39, pasi u konstatua se vlera e tyre e drejtë nuk mund të vlerësohej në mënyrë të besueshme. Në vitin aktual financiar, vlera e drejtë është përcaktuar në përputhje me kërkesat e SNRF 9, i cili nuk lejon matjen me kosto. Aktivete në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Banka konstatoi se në periudhën aktuale vlera e drejtë e këtyre investimeve përafrohet me vlerën e tyre kontabël. Obligacionet qeveritare të grupit të klasifikuar më parë si të mbajtura për tregtim sipas SNK 39 futen në këtë kategori.

###### *Aktivete financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse (“FVOCI”),*

Grupi llogarit aktivete financiare në FVOCI nëse aktivete plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektivi i të cilit është “të mbajtura për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale” e flukseve monetare të lidhura dhe të shesë dhe
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çregjistrimit të aktivitetit. Obligacionet e qeverisë dhe bonot e thesarit, obligacionet e korporatave, letrat me vlerë premtuese, letrat me vlerë të aktiveve dhe portfoli i kapitalit të klasifikuar si të disponueshme për shitje sipas SNK 39, bëjnë pjesë në këtë kategori.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (vi) Netimi

Aktivitetet financiare netohen me detyrimet financiare dhe vlera e tyre neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje të lindura nga një grup veprimesh të ngjashme si në rastin e aktiviteteve tregtare të Bankës.

##### (vii) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e këstit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

##### (viii) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet, ose një detyrim mund të shlyhet, midis palëve të mirëinformuara dhe me vullnet të plotë në kushte të lira tregu në datën e matjes.

Banka e llogarit vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmime të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument, në rast se këto janë të disponueshme. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë rregullisht të gatshme dhe paraqesin veprimet aktuale të vazhdueshme në kushte të lira tregu.

Në qoftë se nuk ka treg aktiv për një instrument financiar, Banka vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e veprimeve më të fundit të kryera midis palëve të vullnetshme, të mirë informuara (nëse ka të tilla), krahasime me vlerën e drejtë për instrumente të tjerë të ngjashëm, analizat e fluksit monetar të skontuar, modelet e vendosjes së çmimit për opsionet. Teknika e vlerësimit e zgjedhur përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të Bankës. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në caktimin e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vlerësimin e instrumenteve financiarë. Inputet për teknikat e vlerësimit pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rrezikut të kthimit, të qenësishëm në instrumentin financiar. Banka rishikon teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmëri, duke përdorur çmime nga veprime aktuale të mbikëqyrura lidhur me të njëjtin instrument, ose bazuar në të dhënat e disponueshme e të mbikëqyrura në treg.

Kur një aktiv është blerë ose një pasiv është krijuar në një transaksion këmbimi për atë aktiv ose pasiv, çmimi i transaksionit është çmimi i paguar për të blerë aktivin ose i marrë për të krijuar pasivin (një çmim hyrje). Në të kundërt, vlera e drejtë e aktivitetit ose detyrimit është çmimi që do të marrë për të shitur aktivin ose paguar për transferimin e detyrimit (një çmim dalje). Në shumë raste çmimi i transaksionit është i barabartë me vlerën e drejtë (që mund të jetë rasti kur në datën e transaksionit, transaksioni për të blerë një aktiv zhvillohet në tregun në të cilin pasuria do të shitet). Në përcaktimin nëse vlera e drejtë në njohjen fillestare është e barabartë me çmimin e transaksionit, Banka merr në konsideratë faktorë të veçantë të lidhur me transaksionin, aktivin ose pasivin.

Kur çmimi i transaksioneve paraqet evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të marrë nga një model vlerësimi, është njohur më pas në fitim ose humbje në varësi të fakteve individuale dhe rrethanave të transaksionit, por jo më vonë momentit kur vlerësimi është mbështetur plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose transaksioni është mbyllur.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (ix) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritura të kreditit - 'modelin e pritur të humbjes së kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, aktivet e kontratave të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe angazhimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk është më e varur nga identifikimi një ngjarje të humbjes së kredisë. Në vend të kësaj, Grupi konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritura të kredisë, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritur të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje që përfshin parashikime të të ardhshmes, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga fillimi njohjes ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Stadi 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Stadi 2').

'Stadi 3' do të përfshijë aktivet financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.'12 - mujore humbjet e pritshme të kredisë 'nihen për kategorinë e parë, ndërsa' humbjet e pritshme të kreditimit njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

##### (x) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (periudha krahasuese)

Në vitin paraprak, zhvlerësimi i aktiveve financiare u bazua në modelin e humbjeve të ndodhura. Banka ka vlerësuar nëse ka pasur dëshmi objektive se aktivet financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare u zhvlerësuan kur dëshmitë objektive treguan se një ngjarje humbjeje kishte ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe se ngjarja e humbjes ndikon në flukset monetare të ardhshme të aktivitetit që mund të vlerësoheshin me besueshmëri.

Banka konsideronte dëshmi të zhvlerësimit për huatë dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim si në nivel individual dhe në nivelin kolektiv. Të gjitha kreditë me vlerë të konsiderueshme dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim vlerësoheshin për zhvlerësime specifike. Të gjitha kreditë me vlerë të konsiderueshme dhe letrat me vlerë të investimit që mbahen deri në maturim, të cilat nuk ishin specifikisht të zhvlerësuar, u vlerësoheshin kolektivisht për çdo zhvlerësim që ka ndodhur por nuk është identifikuar ende.

Huatë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim që nuk ishin individualisht të konsiderueshme u vlerësuan kolektivisht për zhvlerësim duke grupuar së bashku huatë dhe letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim me karakteristika të ngjashme të rrezikut.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar janë matur si diferencë midis vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritjeje kundrejt huave. Interesi mbi aktivitetin e zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet zbritjes së zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e shumës së humbjes nga zhvlerësimi, ulja në humbjen nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të investimit të vlefshme për shitje u njohën duke transferuar humbjen kumulative që ishte njohur drejtpërdrejt në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje. Humbja kumulative e riklasifikuar nga të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje ishte diferenca midis koston së blerjes, neto nga çdo shlyerje e principalit dhe amortizimit dhe vlerës aktuale të drejtë, minus çdo humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provigjonet e zhvlerësimit që i atribuohen vlerave në kohë janë pasqyruar si një përbërës i të ardhurave nga interesi. Nëse në një periudhë pasardhëse vlera e drejtë e një portofoli të borxhit të zhvlerësuar është në rritje dhe rritja mund të lidhet objektivist me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi rimerret me shumën e anulimit të njohur në fitim ose humbje.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (xi) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Grupit nuk kanë ndikuar nga miratimi i SNRF 9. Detyrimet financiare të Grupit përfshijnë huatë e depozitave të klientëve nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, borxhi i varur dhe të tjera të pagueshme.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Grupi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse). Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

##### (xii) Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës

Grupi zbaton kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës në SNRF 9 prospektivisht

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVTPL) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse të fluksit monetar, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- efekti i rrezikut të kredisë nuk dominon ndryshimet e vlerës që rrjedhin nga ajo marrëdhënie ekonomike
- raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën mbrojtëse të fluksit të mjeteve monetare në kapitalin neto. Çdo mosfunksionim në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjeragjithëpërfshirëse. Megjithatë, nëse një aktiv ose pasiv jo financiar njihet si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të elementit të mbrojtur. Nëse një transaksion parashikues nuk pritet të ndodhë më, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse bartet menjëherë në fitim ose humbje. Nëse marrëdhënia mbrojtëse ndalon së përbushuri kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit neto derisa të ndodhë transaksioni parashikues.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (h) Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore dhe të tjera aktive financiare shume likuide, me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat nuk janë subjekt i një rreziku domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe që përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

#### (i) Derivatët e mbajtur për manaxhimin e rrezikut

Derivatët e mbajtur për menaxhimin e riskut përfshijnë të gjithë aktivet dhe detyrimet derivative, të cilat nuk klasifikohen në aktivet apo detyrimet e tregtueshme. Derivatët e mbajtur për qëllime të administrimit të riskut mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë.

#### (j) Huatë

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë apo në periudhën afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (apo aktiv shumë të ngjashëm me të) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("marrëveshje të anasjella të riblerjes"), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rasti kur Banka zgjedh të mbajë huatë dhe paradhëniet me vlerën drejtëpërmjet fitim/humbjes siç përshkruhet në politikat kontabël 3(g),(iii).

#### (k) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

##### (i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentët kryesorë) të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

##### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese a të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të elementit, nëse është e mundshme që Banka në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike, që i atribuohen atij elementi, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin

##### (iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve afatgjata të trupëzuara. Toka nuk zhvlerësohet.

Vlerësimi për jetën e dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

- Ndërtesa dhe përmirësime të ambjenteve me qira 20 vjet
- Mjete transporti dhe pajisje të tjera 5 vjet
- Pajisje zyre 5 vjet
- Kompjuterat dhe pajisje elektronike 4 vjet

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (l) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara përfshijnë programet kompjuterike të blera nga Banka. Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet për zhvillimin e programeve kompjuterike nga vetë Banka njihen si aktive kur Banka është në gjendje të tregojë qëllimin dhe aftësinë për të plotësuar zhvillimin dhe përdorur programet kompjuterike në një mënyrë që do të gjenerojë përfitime ekonomike të ardhme, dhe mundet të masë me besueshmëri kostot e përfundimit të zhvillimit. Kapitalizimi i kostove të programeve të zhvilluara nga vetë Banka përfshin të gjithë kostot që i atribuohen direkt zhvillimit të programit kompjuterik dhe amortizohen me jetën e dobishme të tyre. Zhvillimi nga vetë Banka i programeve kompjuterike shprehet me koston e kapitalizuar duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë.

Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivitetit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është vlerësuar në katër vjet.

#### (m) Aktive të marra përmes proceseve gjyqësore (Kolaterale të riposeduara)

Kolaterale të riposeduara përfaqësojnë aktivet financiare dhe jofinanciare të blera nga Grupi për shlyerjen e kredive të prapambetura. Aktivet fillimisht njihen me vlerën e drejtë kur janë blerë dhe përfshihen në aktive afatgjata materiale, aktivet e tjera financiare, investime në prona ose inventarë brenda aktiveve të tjera në varësitë natyresë të tyre dhe synim të Grupit për rikuperimin e këtyre aktiveve dhe më pas rimaten dhe llogariten në përputhje me politikën kontabël për këto kategori të aktiveve. Grupi zbaton politikën e tij kontabël për aktivet afatgjata që mbahen për shitje ose të nxjerrë jashtë përdorimit për ato kolaterale të riposeduara kur kushtet përkatëse për këtë klasifikim plotësohen në fund të periudhës raportuese.

Kur kolaterali i riposeduar rezulton në marrjen e kontrollit mbi një biznes, kombinimi i biznesit llogaritet duke përdorur metodën e blerjes së kontabilitetit me vlerën e drejtë të kredisë së shlyer që përfaqëson koston e blerjes (referojuni politikave kontabël për konsolidim). Politika e kontabilitetit për pjesëmarrjet aplikohet në aksione të riposeduara ku Grupi merr ndikim të rëndësishëm, por jo kontroll. Kostoja e pjesëmarrjes është vlera e drejtë e huasë e shlyer nga riposedimi i aksioneve të premtuara.

#### (n) Rënia e vlerës së aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënie vlere. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të matura për njësi gjeneruese të mjeteve monetare, fillimisht zvogëlojnë vlerën kontabël të ndonjë aktivi jo-material që është pjesë e njësisë dhe pastaj redukton vlerën kontabël të aktiveve të tjera në njësi (apo grup njësisish) me një shpërndarje proporcionale mes tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të vlerësuarara të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidencë nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më.

Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin ose amortizimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia e vlerës tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin ose amortizimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia e vlerës.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (p) Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta trajtohen duke përdorur metodën e kapitalit neto. Vlera kontabël neto e investimit në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkët rritet ose zvogëlohet për të njohur pjesën e Grupit të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjes dhe sipërmarrjes së përbashkët, të përshtatura aty ku është e nevojshme për të siguruar përputhshmëri me politikën kontabël të Grupit. Fitimet dhe humbjet e përcaktuara mbi transaksionet midis Grupit dhe shoqërive dhe sipërmarrjeve të përbashkëta eliminohen në masën e interesit të Grupit në ato njësi ekonomike. Kur humbjet e përcaktuara janë eliminuar, aktiviteti themelor testohet gjithashtu për zhvlerësim.

#### (q) Depozitat, huatë dhe borxhi i varur

Depozitat, huatë dhe borxhi i varur janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen ("repo" ose "huadhenie aksioni"), marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktiviteti vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat, huatë dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### (r) Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv të tanishëm i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka mundësi që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e të mirave ekonomike.

Provigjionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit. Një provigjion për ristrukturimin njihet kur Banka ka aprovuar një plan ristrukturimi të detajuar dhe formal dhe ristrukturimi ka filluar apo është publikuar. Kostot e ardhme operative nuk provigjionohen.

Një provigjion për kontratat pa fitim njihet kur përfitimet e pritshme për t'u marrë nga Banka për këto kontrata, janë më të vogla se kostot e pashmangshme për të plotësuar detyrimin sipas kontratës. Provigjioni matet me vlerën aktuale të më të voglës mes kostos së pritshme të përfundimit të kontratës dhe kostos neto të pritshme për të vazhduar me kontratën. Para se një provigjion të krijohet, Banka njezh çdo humbje zhvlerësimi të aktiveve që lidhen me atë kontratë.

#### (s) Përfitimet e punonjësve

##### (i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që mbulojnë përfitimet e punonjësve pasi dalin në pension. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për dhënien e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (s) Perfitimet e punonjësve

##### (ii) Plani i përfitimit të pensionit

Banka ka krijuar një fond plan pensioni, plotësisht të financuar nga punëdhënësi i quajtur Programi i Mbështetjes së Stafit (shiko shënimin 20 “Fondi rezervë për pensionin e punonjësve”) në vitin 2002. Shuma që regjistrohej tek ky fond (“PMS”) vendosej në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit.

Sipas planit të mësipërm, shumës së përlogaritur për punonjësit i shtohet interesi, i cili llogaritej që nga data kur punonjësit do të largoheshin dhe deri në daljen e tyre në pension. Kjo shumë do t’i paguhet punonjësve, vetëm kur ata të mbërrijnë moshën e pensionit, përcaktuar sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me minimumin e 75% e pensionit mujor shtetëror derisa fondi i akumuluar për punonjësit të konsumohet.

Bazuar në rezolutën e Këshillit Drejtues, në fuqi që nga 30 shtatori 2010, Banka ka ndaluar së investuari në këtë fond (“PMS”), duke e transformuar atë në Programin e Kredisë për Mbajtjen e Stafit (‘PKMS’). Ndryshimet demografike në forcën punëmarrëse gjatë dhjetë viteve të fundit dhe moshë mesatare 31 vjeç e punonjësve, ku 80% e punonjësve janë nën moshën 40 vjeç, ka rezultuar se PMS nuk është tërheqëse për pjesën më të madhe të punonjësve të Bankës, pasi mund të gëzohet vetëm me daljen në pension. Në dallim nga ky plan, PKMS do të jetë më i dobishëm për të gjithë punonjësit e Bankës, sepse do të ofrojë kredi për shtëpi apo kredi konsumatore me terma preferencialë. Shuma e llogaritur për personat përfitues nga Programi i Mbështetjes së Stafit është ngrirë në të njëjtën datë. Shuma e ngrirë si pasojë e transformimit të programit të “PMS” në “PKMS” më 30 shtator 2010 dhe pjesa korresponduese e interesit vjetor, që do fitohet në të ardhmen deri në moshën e pensionit, matet në bazë të normës së obligacioneve qeveritare AAA, dhe regjistrohet si detyrim nga Banka.

##### (iii) Përfitimet afat-shkurtra

Detyrimet e përfitimeve afat-shkurtër të punonjësve maten në baza të paskontuara dhe janë shpenzuar sipas kryerjes së shërbimit lidhur me to.

Për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimit monetar afat-shkurtër ose planeve të ndarjes së fitimeve, nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv të paguajë këtë shumë si rezultat i shërbimeve të kaluara të kryera nga punonjësit dhe detyrimet mund të maten në mënyrë të besueshme, njihet provigjion.

##### (t) Raportimi i segmenteve

Një segment operues është një komponent i Bankës që është i përfshirë në aktivitete biznesi, nga të cilat mund të fitojë të ardhura dhe të kryejë shpenzime, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me veprimet me komponentë të tjerë të Bankës, dhe rezultatet operative të të cilit, rishikohen në mënyrë të rregullt nga menaxhimi për të marrë vendime rreth ndarjes së burimeve të secilit segment dhe për të vlerësuar performancën e tyre, dhe për të cilin duhet informacion i veçantë i vlefshëm (shih shënimin 6). Forma e përdorur prej Bankës për raportim të segmentuar është bazuar në segmentimin gjeografik.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (u) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018

##### SNRF 15 “Të ardhurat nga kontratat me klientët”

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 “Të ardhurat”, SNK 11 “Kontratat e ndërtimit”, dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat.

SNRF 15 “Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët” dhe Sqarimet në SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët (në tekstin e mëposhtëm “SNRF 15”) zëvendësojnë SNK 18 ‘Të Ardhurat’, SNK 11 ‘Kontratat e Ndërtimit’ dhe disa të ardhura lidhur me Interpretimet.

Standardi i ri krijon një model njohjeje të të ardhurave të bazuar te kontrolli dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohej në mënyrë të detajuar nga SNRF-të ekzistuese, duke përfshirë mënyrën e kontabilizimit të marrëveshjeve me detyrime të shumta të performancës, çmime të ndryshueshme, të drejta të rimbursimit të konsumatorit, opsione të riblerjes nga furnitorët, dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

Zbatimi i këtij udhëzimi të ri nuk ka ndikim të rëndësishëm në kohën ose shumën e të ardhurave të njohura nga Grupi në çdo vit. Sikur zbatimi të rezultojë në një ndikim domethënës, standardi i ri do të zbatohet në mënyrë retrospektive pa riparaqitje, me efektin kumulativ të aplikimit fillestar të njohur si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të mbajtura më 1 janar 2018.

##### SNRF 9 “Instrumentat Financiare”

SNRF 9 “Instrumentet financiare” (SNRF 9) zëvendëson SNK 39 “Instrumentet financiare: Njohja dhe matja”. SNRF 9 ka prezantuar një koncept të ri të klasifikimit dhe matjes së aktiveve financiare dhe një model të ri “humbje të pritshme të kredisë” për zhvlerësimin e aktiveve financiare.

Gjatë adoptimit të SNRF 9, Grupi ka aplikuar lehtësim në tranzicion dhe ka vendosur të mos ripërtërijë periudhat paraprake. Diferencat që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në lidhje me klasifikimin, matjen dhe zhvlerësimin njihen në fitimet e pashpërndara.

Banka ka miratuar politika të reja kontabël, duke zbatuar kërkesat e SNRF 9, në fuqi që nga 1 janari 2018. Banka gjithashtu ka vlerësuar ndikimin e SNRF 9 në aktivet e saj financiare dhe ka përmirësuar dhe përshtatur kërkesat ekzistuese të biznesit dhe ka miratuar rregullore të reja për të përfshirë kërkesat e SNRF 9.

Banka ka vlerësuar ndikimin e SNRF 9, në fushat e mëposhtme:

#### 1) Klasifikimi i aktiveve financiare

Klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare më ose pas datës 1 janar 2018 bazohet në kritere të reja që marrin parasysh flukset monetare kontraktuale të instrumenteve financiare dhe modelin e biznesit në të cilin ato menaxhohen. SNRF 9 përfshin tre kategori kryesore të klasifikimit për aktivet financiare: të matura me koston e amortizuar (AC), të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI) dhe të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVPL). Standardi eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të vlefshme për shitje.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (u) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018

##### 1) Klasifikimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Bazuar në modelin e biznesit të përzgjedhur, Banka ka vendosur t'i klasifikojë aktivet e saj financiare në kategoritë e mëposhtme më 1 janar 2018:

Portofoli i rishikuar më 31 dhjetor 2017	SNK 39 Matja, klasifikimi		Testi SPPI	Modeli i biznesit	SNRF 9 Matja, klasifikimi	Konkluzion
<b>Treasury</b>						
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	HTM	AC	Përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	Nuk u identifikua impakt financiar
Depozita dhe llogari me bankat	HTM	AC	Përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	Nuk u identifikua impakt financiar
Bono thesari të vlefshme për shitje	AFS	FVOCI	Përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar dhe shitur	FVOCI	Nuk u identifikua impakt financiar
Investime të vlefshme për shitje	AFS	FVOCI	Përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar dhe shitur	FVOCI	Nuk u identifikua impakt financiar në këtë fazë. Megjithatë çdo instrument i ri që do të dështojë testin SPPI në të ardhmen do të matet me FVPL, me luhatjet e rëndësishme të humbje fitimit si pasojë e ndryshimeve në vlerën e drejtë.
Investime të mbajtura deri në maturim	HTM	AC	Përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	Vetëm 3% e portofolit të huave ndaj bankave u shitën në vitin 2017, 13% në 2016 dhe 10.4% në vitin 2015. Duke pasur parasysh frekuencën dhe parëndësinë e tyre në vitet e mëparshme, shitjet mund të jenë në përputhje me një model biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare mbledhur flukset monetare kontraktuale. Për më tepër qëllimi idretimit të Bankës është t'i mbajë këto aktive deri në maturim.
<b>Hua për bankat</b>	LAR	AC	Meet SPPI criteria	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	
<b>Hua për klientët</b>			Meet SPPI criteria			
Kredi konsumatore dhe për korporatat	LAR	AC	Meet SPPI criteria	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	Nuk u identifikua impakt financiar

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (u) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018

#### 2) Humbjet e pritshme të kredisë më 1 janar 2018

Ndikimi më i rëndësishëm në pasqyrat financiare të Grupit nga zbatimi i SNRF 9 rezulton nga kërkesat e reja të zhvlerësimit. Humbjet nga zhvlerësimi janë rritur dhe janë bërë më të paqëndrueshme për instrumentet financiare në kuadër të modelit të SNRF 9 të zhvlerësimit.

Vlerësimi i rrezikut të kredisë të një portofoli të aktiveve përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me gjasat e mosveprimeve të ndodhura, të raporteve të humbjeve të lidhura dhe korrelacioneve të paracaktuara ndërmjet palëve. Grupi mat rrezikun e kredisë duke përdorur probabilitetin e paracaktuar (PD), ekspozimin në mospagim (EAD) dhe humbjen e dhënë default (LGD). Shih shënimin 5 (b), (ii).

Inputet kryesore në matjen e ECL-ve të vlerësuara dhe të rregulluara në bilancin fillestar të kapitalit të bankave më 1 janar 2018 janë të njëjta me ato të shënimit 5 (b), (ii), me përjashtim të LGD-së e cila u vlerësua si më poshtë:

Më 1 janar 2018, Banka mori vlerësimet e bazuara fikse. Bankat përcaktojnë secilën lloj kolaterali në portofolin e BKT-së në segmentet LGD të Bazelit, secila me normën përkatëse të LGD-së: Kolateral financiar i kualifikuar (0%), i siguruar (25%), i pasiguar (45%) dhe i varur i pasiguar (75%). Kur një llogari ka kolateral (e) që i përket një segment të Bazelit të LGD-së, vlera LGD e caktuar për atë segment përdoret për të gjitha llogaritë sipas palës në fjalë. Në rastin kur një llogari ka disa lloje të kolateralit, vlera e ponderuar e vlerës së kolateralit LGD përdoret për të gjitha llogaritë në kuadër të kundërpartisë në fjalë. Për portofolet e Thesarit dhe Projektit dhe Strukturuar Financave, vlerat LGD janë caktuar në një nivel të tipit të aktivitetit.

Gjatë vitit 2018, Banka rishikoi vlerësimin e LGD-së siç shpjegohet në shënimin 5 (b), (ii). Më 31 dhjetor 2018, Banka aplikoi ndryshimin në ECL, që rrjedh nga vlerësimi i LGD-së, në mënyrë prospektive.

Bazuar në vlerësimet e ndërmarra, rregullimi i përgjithshëm i parashikuar i adoptimit të SNRF 9 në bilancin fillestar të kapitalit të bankave më 1 janar 2018 ishte rreth 6,137,861 USD.

Totali i provigjoneve arrin në 55,921,887 USD, ose njëlloj 1,84% të totalit të ekspozimit.

Banka ka vendosur që të mos rivendosë periudhat krahasuese në zbatimin fillestar të SNRF 9.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018  
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (u) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018 (vazhdim)

#### 2) Humbjet e pritshme të kredisë më 1 janar 2018 (vazhdim)

#### i. Rakordimi i gjendjes së Pasqyrës së Pozicionit Financiar nga SNK 39 në SNRF 9 (vazhdim)

Në USD	Klasifikimi original sipas SNA 39	Klasifikimi sipas SNRF 9	Vlera kontabël origjinale sipas SNA 39	Rimatja	Vlera kontabël e re sipas SNRF 9	
<b>Aktive financiare</b>						
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	295,119,649	-	295,119,649
Depozita dhe llogari me bankat	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	Depozita dhe llogari me bankat	293,887,630	-	293,887,630
Bono Thesari	AFS	FVOCI	Letra me vlerë – të matura në FVOCI	209,396,356	-	209,396,356
Investime të mbajtura për tregtim	FVTPL	FVTPL	Letra me vlerë - të matura në FVTPL	-	-	-
Investime të vlefshme për shitje	AFS	FVOCI	Letra me vlerë - të matura në FVOCI	1,002,510,212	435,063	1,002,075,149
Investime të mbajtura deri në maturim	HTM	Kosto e amortizuar	Letra me vlerë-të matura me koston e amortizuar	160,524,664	135,930	160,388,734
Hua për bankat	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	Hua për bankat	424,728,134	827,877	423,900,257
Hua për klientët	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	Hua për klientët	1,172,497,193	4,578,049	1,167,919,144
Aktive të tjera	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e amortizuar	Aktive të tjera	14,285,515	160,942	14,124,573
<b>Totali i aktiveve financiare</b>				<b>3,572,949,353</b>	<b>6,137,861</b>	<b>3,566,811,492</b>
<b>Detyrime financiare</b>						
Detyrime ndaj klientëve	Kosto e amortizuar	Kosto e amortizuar	Detyrime ndaj klientëve	2,867,899,348	-	2,867,899,348
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	Kosto e amortizuar	Kosto e amortizuar	Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	343,706,001	-	343,706,001
Detyrime ndaj palëve të treta	Kosto e amortizuar	Kosto e amortizuar	Detyrime ndaj palëve të treta	4,856,919	-	4,856,919
Detyrime të tjera	Kosto e amortizuar	Kosto e amortizuar	Detyrime të tjera	17,492,677	-	17,492,677
Borxhi i varur	Kosto e amortizuar	Kosto e amortizuar	Borxhi i varur	29,989,497	-	29,989,497
<b>Totali i detyrimeve</b>				<b>3,263,944,442</b>	<b>-</b>	<b>3,263,944,442</b>



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018  
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (u) Standardet e reja të miratuara më 1 janar 2018 (vazhdim)

#### 2) Humbjet e pritshme të kredisë më 1 janar 2018 (vazhdim)

#### i. Rakordimi i gjendjes së Pasqyrës së Pozicionit Financiar nga SNK 39 në SNRF 9 (vazhdim)

Tabela në vijim analizon ndikimin, neto të tatimit, të kalimit në SNRF 9 mbi rezervat dhe fitimet e pashpërndara. Ndikimi lidhet me rezervën e kredive të detyrimeve, rezervën e vlerës së drejtë dhe fitimet e pashpërndara. Nuk ka ndikim në komponentët e tjerë të kapitalit.

Në USD	Efekti i aplikimit të SNRF 9 në 1 janar 2018
<b>Rezerva e vlerës së drejtë (SNK 39 aktive të vlefshme për shitje)</b>	
Balanca mbyllëse sipas SNK 39 (31 dhjetor 2017)	4,908,867
Riklasifikimi i letrave me vlerë të investimit (borxhit) nga oferta e vlefshme për shitje në FVTPL	-
Riklasifikimi i letrave me vlerë të investimit (kapitali neto) i matur me kosto nga oferta e vlefshme për shitje në FVOCI	-
Njohja e humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9 për aktivet financiare të borxhit në FVOCI	-
<b>Balanca Hapëse nën SNRF 9 (1 janar 2018)</b>	<b>4,908,867</b>
<b>Fitime të pashpërndara</b>	
Balanca mbyllëse sipas SNK 39 (31 dhjetor 2017)	109,136,340
Riklasifikimet sipas SNRF 9	6,137,861
Njohja e humbjeve të pritshme të kredisë sipas SNRF 9 (duke përfshirë të arkëtueshmet e qirasë, angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare)	-
<b>Balanca Hapëse sipas SNRF 9 (1 janar 2018)</b>	<b>102,998,479</b>

Tabela në vijim rakordon mbylljen e fondit të zhvlerësimit për aktivet financiare në përputhje me SNK 39 dhe provizionet për angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare në përputhje me SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara më 31 Dhjetor 2017, në hapjes ECL të përcaktuar në përputhje me SNRF 9 më 1 janar 2018.

Provizioni në USD	31 December 2017 (IAS 39/ IAS 37)	Reclassification to FVTPL measurement	Remeasurement	1 January 2018 (IFRS 9)
<b>Aktive financiare</b>				
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	-		-	-
Depozita dhe llogari me bankat	-		-	-
Letra me vlerë të mbajtura për shitje sipas SNA 39)	-		135,930	135,930
Hua për bankat (H&A sipas SNA 39)	-		827,877	827,877
Hua për klientët (H&A sipas SNA 39)	49,784,026		4,578,049	54,362,075
Aktive të tjera	-		160,942	160,942
<b>Fondi total i zhvlerësimit sipas matjes me koston e amortizuar</b>	<b>49,784,026</b>	<b>-</b>	<b>5,702,798</b>	<b>55,486,824</b>
Letra me vlerë të vlefshme për shitje sipas SNA 39)	-		435,063	435,063
<b>Fondi total i zhvlerësimit sipas matjes FVOCI</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>435,063</b>	<b>435,063</b>

Informacione shpjeguese të mëtejshme për matjen e provizionit sipas SNRF 9 mund të gjenden në shënimin 3 (g) (ix) dhe 5 (b) (ii).

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (v) Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Grupi.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, si dhe ndryshime të standardeve ekzistuese, që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Grupi, janë publikuar nga BSNK. Informacion mbi ato standarde që pritet të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Grupit është dhënë më poshtë. Drejtimi pret që të gjitha standardet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Grupit për periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet të cilat nuk janë miratuar apo të shënuara më poshtë nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Grupit.

#### SNRF 16 'Qiratë Financiare'

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 'Qiratë' dhe tre Interpretime të lidhura. Përfundon projektin afatgjatë të BSNK-së për të rishikuar kontabilitetin e qirasë. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një aktivi të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje. Ekzistojnë dy lehtësime të rëndësishme të parashikuara nga SNRF 16 për aktivet me vlerë të ulët dhe me qira afatshkurtër më pak se 12 muaj.

SNRF 16 zbatohet nga periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Miratimi i hershëm është i lejuar; megjithatë, Grupi ka vendosur të mos miratojë herët.

Drejtimi është në proces të vlerësimit të ndikimit të plotë të Standardit. Deri më tani, Grupi:

- ka vendosur të përdorë mjetet praktike për të mos bërë një rishikim të plotë të qirasë ekzistuese dhe të zbatojë SNRF 16 vetëm për kontratat e reja ose të modifikuara. Pasi që disa qiratë do të modifikohen ose rinovohen në vitin 2019, Grupi ka rivlerësuar këto qiratë dhe ka përfunduar se ato do të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv të së drejtës së përdorimit.
- beson se ndikimi më i rëndësishëm do të jetë që Grupi do të duhet të njohë një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje për zyrën dhe ndërtesat që aktualisht trajtohen si qira operationale. Kjo do të thotë se natyra e shpenzimeve të do të ndryshojë nga të qenit një shpenzim operativ i qirasë ndaj zhvlerësimit dhe shpenzimeve të interesit
- konsideron kërkesat e sistemit të TI-së dhe nëse nevojitet një sistem i ri leasing.
- vlerëson shënimet shpjeguese të tyre aktuale për qiratë financiare dhe qiratë operationale (Shënimi 33, Seksioni, 'Angazhimet e qirasë') pasi këto mund të krijojnë bazën e shumave që duhet të kapitalizohen dhe të bëhen aktive të së drejtës së përdorimit
- vlerëson dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë që do të kërkohen.

Grupi planifikon të miratojë SNRF 16 më 1 janar 2019 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive të Standardit. Sipas kësaj qasjeje, efekti kumulativ i zbatimit fillimisht të SNRF 16 njihet si një rregullim në kapital në datën e aplikimit fillestar. Informacioni krahasues nuk riparohet.

Zgjedhja e kësaj qasjeje të tranzicionit rezulton në vendime të mëtejshme të politikave që Grupi duhet të bëjë pasi ka disa lehtësime të tjera kalimtare që mund të aplikohen. Këto lidhen me ato qera të mbajtura më parë si qera të zakonshme dhe mund të aplikohen në bazë të qirasë. Grupi po vlerëson aktualisht ndikimin e zbatimit të këtyre lehtësimeve të tjera kalimtare. SNRF 16 nuk ka bërë ndonjë ndryshim domethënës në kontabilitetin për qiradhënësit, prandaj Grupi nuk pret ndonjë ndryshim për qira, ku ata veprojnë si qiradhënës.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi diskuton me Komitetin e Auditimit mbi zhvillimin, zgjedhjen dhe shënimet shpjeguese të politikave dhe vlerësimeve kritike të Bankës, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih shënimin 5).

Në vijim janë gjykimet kritike, përveç atyre që përfshijnë vlerësimet (që trajtohen më poshtë më poshtë), që drejtimi ka bërë në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Grupit dhe që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare:

Vlerësimi i modelit të biznesit: Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare varet nga rezultatet e SPPI dhe testit të modelit të biznesit (shënimi 3, g), (iii)). Grupi përcakton modelin e biznesit në një nivel që reflekton se si grupet e aktiveve financiare menaxhohen së bashku për të arritur një objektiv të caktuar biznesi. Ky vlerësim përfshin gjykimin që pasqyron të gjitha provat relevante, duke përfshirë vlerësimin e performancës së aktiveve dhe matjen e performancës së tyre, rreziqet që ndikojnë në performancën e aktiveve dhe mënyrën se si menaxhohen ato dhe si kompensohen menaxherët e aktiveve. Grupi monitoron aktivet financiare të matura me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që çregjistrohen përpara maturimit të tyre për të kuptuar arsyen për nxjerrjen e tyre dhe nëse arsyet janë në përputhje me objektivin e biznesit për të cilin është mbajtur pasuria. Monitorimi është pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të Grupit nëse modeli i biznesit për të cilin mbahet pasuria financiare e mbetur vazhdon të jetë e përshtatshme dhe nëse nuk është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në modelin e biznesit dhe kështu një ndryshim të ardhshëm në klasifikimin e tyre.

Rritja e ndjeshme e rrezikut të kredisë: Siç është shpjeguar në shënimin 3 (g) (ix) dhe 5 (b) (ii), ECL matet si një kompensim i barabartë me ECL 12 muaj për aktivet e fazës 1 ose aktivet ECL të jetës për fazën 2 ose aktivet e fazës së tretë. Një aktiv lëviz në fazën 2 kur rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. SNRF 9 nuk përcakton se çfarë përbën një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë. Në vlerësimin nëse rreziku i kredisë i një aktivi ka rritur ndjeshëm Grupin merr parasysh informacionin cilësor dhe sasior të arsyeshëm dhe të mbështetur përpara. Referojuni shënimin 3 (g) (ix) dhe 5 (b) (ii), për më shumë detaje.

Krijimi i grupeve të aktiveve me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë: Kur ECL-të maten në baza kolektive, instrumentet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të rrezikut të përbashkët. Referojuni shënimin 3 (g) (ix) dhe 5 (b) (ii), për detajet e karakteristikave të shqyrtuara në këtë aktgjykim. Grupi monitoron përshtatshmërinë e karakteristikave të rrezikut të kredisë në mënyrë të vazhdueshme për të vlerësuar nëse ato vazhdojnë të jenë të ngjashme. Kjo është e nevojshme për të siguruar që karakteristikat e rrezikut të kredisë të ndryshojnë, ka ri-segmentim të duhur të aktiveve. Kjo mund të rezultojë në krijimin e portofolave të rinj ose në lëvizjen e aktiveve në një portofol ekzistues që reflekton më mirë karakteristikat e ngjashme të rrezikut të kredisë të atij grupi të aktiveve. Ri-segmentimi i portofoleve dhe lëvizja midis portofoleve është më e zakonshme kur ka një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë (ose kur kjo rritje e rëndësishme ndryshon) dhe kështu aktivet lëvizin nga 12-mujore në ECL-të e jetës, ose anasjelltas, por kjo mund të ndodhë edhe brenda portofoleve që vazhdojnë të maten në të njëjtën bazë të ECL-ve 12-mujore ose të jetës, por shumat e ndryshimeve të ECL sepse rreziku i kredisë së portofoleve ndryshon.

Modelet dhe supozimet e përdorura: Grupi përdor modele të ndryshme dhe supozime në matjen e vlerës së drejtë të aktiveve financiare si dhe në vlerësimin e ECL. Gjykimet zbatohet në identifikimin e modelit më të përshtatshëm për secilin lloj të aktivitetit, si dhe për përcaktimin e supozimeve të përdorura në këto modele, duke përfshirë supozimet që lidhen me drejtuesit kryesorë të rrezikut të kredisë. Shih shënimin 3 (g) (ix) dhe 5 (b) (ii) për më shumë detaje mbi ECL dhe shënimin 3 (g) (viii) për më shumë detaje mbi matjen e vlerës së drejtë.

### Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka një çmim tregu të dukshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhen në politikën kontabël 3(g)(viii). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe që nuk kanë transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi bazuar në likuiditetin, përqendrimin, pasigurinë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik. Referoju gjithashtu "Vlerësimi i instrumenteve financiarë" më poshtë.



## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës përfshijnë:

#### Vlerësimi i instrumenteve financiarë

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së drejtë është trajtuar në shënimin 3(g)(viii).

Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në inpute të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur çmime të kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të vëzhgueshëm në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku kërkohen rregullime apo gjykime të rëndësishme e të pavëzhgueshme për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime tregu të kuotuar apo kuotime të agjentëve. Për të gjitha instrumentet e tjerë financiarë Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrës në treg që veprojnë me kushtet e tregut.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë më të thjeshtë dhe më të zakonshëm, si norma interesi dhe këmbime monedhash që përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim apo vlerësim nga drejtuesit. Çmimet dhe inputet model të vëzhgueshme janë zakonisht të vlefshme në treg për instrumente kapitale dhe huaje të listuara në bursa, derivativë të tregtueshëm me këmbim, dhe derivativë të thjeshtë të tregtueshëm mbi banak si Swaps mbi normat e interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe e inputeve model redukton nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e drejtuesve dhe redukton gjithashtu pasigurinë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe inputeve varion në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarjet specifike dhe kushtet e përgjithshme në tregjet financiare.

Për instrumente financiare më komplekse, Banka përdor modele vlerësimi të veçanta, të cilat janë zakonisht të zhvilluara bazuar në modele të njohura vlerësimi. Disa ose të gjithë inputet e rëndësishme në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme në treg dhe janë rrjedhojë e çmimeve të tregut ose kurseve ose janë vlerësuar bazuar në gjykime. Modelet e vlerësimit që përmbajnë inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi nga drejtuesit në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i drejtuesve kërkohet zakonisht për zgjedhjen e modelit të vlerësimit për t'u përdorur, përcaktimin e flukseve monetare të pritshme për instrumentin financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit për mospagesën apo parapagimet nga pala tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme për skontim.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018  
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

#### Vlera e Drejtë

Tabela më poshtë paraqet vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare, të matura me vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese, sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilën është kategorizuar matja e vlerës së drejtë:

31 dhjetor 2018	Shënime	Vlera kontabël	Vlera e drejtë			Total
			Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	
Depozita dhe llogari me bankat	8	658,318,886	-	658,318,886	-	658,318,886
Letra me vlerë	9	1,486,663,848	446,193,390	1,037,008,393	-	1,483,201,783
Hua për bankat	10	195,676,165	-	195,676,165	-	195,676,165
Hua për klientët	11	1,215,625,631	-	-	1,215,625,631	1,215,625,631
<b>Totali i aktiveve financiare</b>		<b>3,556,284,530</b>	<b>446,193,390</b>	<b>1,891,003,444</b>	<b>1,215,625,631</b>	<b>3,552,822,465</b>
Detyrime ndaj klientëve	16	3,129,749,851	-	-	3,129,749,851	3,129,749,851
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	17	323,861,645	-	323,861,645	-	323,861,645
Borxhi i varur	21	28,678,547	-	28,678,547	-	28,678,547
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>		<b>3,482,290,043</b>	<b>-</b>	<b>352,540,192</b>	<b>3,129,749,851</b>	<b>3,482,290,043</b>
<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>Shënime</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>	<b>Total</b>
Depozita dhe llogari me bankat	8	293,887,630	-	293,887,630	-	293,887,630
Letra me vlerë	9	1,372,431,232	382,958,758	995,490,896	-	1,378,449,654
Hua për bankat	10	424,728,134	-	424,728,134	-	424,728,134
Hua për klientët	11	1,172,497,193	-	-	1,172,497,193	1,172,497,193
<b>Totali i aktiveve financiare</b>		<b>3,263,544,189</b>	<b>382,958,758</b>	<b>1,714,106,660</b>	<b>1,172,497,193</b>	<b>3,269,562,611</b>
Detyrime ndaj klientëve	16	2,867,899,348	-	-	2,867,899,348	2,867,899,348
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	17	343,706,001	-	343,706,001	-	343,706,001
Borxhi i varur	21	29,989,497	-	29,989,497	-	29,989,497
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>		<b>3,241,594,846</b>	<b>-</b>	<b>373,695,498</b>	<b>2,867,899,348</b>	<b>3,241,594,846</b>

Vlera e drejtë e kontratave të kursit të këmbimit i afrohet vlerës kontabël të tyre, siç paraqitet në shënimet 15 dhe 20. Vlera e drejtë e huave për klientët dhe detyrimeve ndaj klientëve i afrohet vlerës së tyre kontabël si pasojë e vlerave të përafërta të normave të interesit me ato të tregut ose për shkak të maturitetit afatshkurtër të tyre.

## Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

### 5. Administrimi i rrezikut financiar

#### (a) Hyrje e përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziqet e tregut
- rreziku operacional

